

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7162
E shtunë, 13 prill 2024
Çmimi 0.50 €

Çmimet e konsumit,
më të larta në marsin
e 2024-s se në marsin
e kaluar, **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SARRAZIN: GJERMANIA NUK PËRKRAH NDONJË FORMË TË ASOCIACIONIT QË MINON INTEGRITETIN E KOSOVËS. **FAQE 5**



I dërguari i posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka bërë me dije se Gjermania nuk përkrah ndonjë formë të Asociacionit të

Komunave me Shumicë Serbe që minon integritetin e Kosovës. Megjithatë, ai ka theksuar se moskrijimi i një bashkësie të komunave me shumicë serbe e

pengon rrugën e Kosovës drejt BE-së. Ai u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i kryejnë obligimet e dala nga procesi i dialogut

AKTUALE



**MACRONI NË KONFERENCË ME
RAMËN: SHQIPËRIA KA AVANCUAR NË
RRUGËN DREJT INTEGRIMIT NË BE. **F. 2****

**IKSHPK-ja: RRIEN RASTET
ME KOLLËN E MIRË. **F. 3****

**PROJEKTLIGJI PËR TEKSTET
SHKOLLORE PROCEDOHET PËR
SHQYRTIM NEN PËR NEN. **F. 6****

**UP-ja REAGON PËR RASTET E
NGACMIMEVE: PALËT TË PËRMBAHEN
NGA ÇFARËDO PRESIONI, RASTET
DUHET TË TRAJTOHEN ME
SERIOZITET. **F. 7****

EKONOMI



**HAPET PANAIRI I TURIZMIT NË
PRISHTINË. **F. 8****

**BANKA QENDRORE EVROPIANE NUK
NDRYSHON NORMAT E INTERESIT. **F. 8****

SPORT



**BALLKANI DHE DRITA PRESIN
FITORET E RADHËS, LLAPI KËRKON
KËNDELLJEN. **F. 12****

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM REGJISTRIMI I POPULLSISË? **F. 4**



AKK-ja KËRKON NGA GJYKATA KOMERCIALE TA SHQYRTOJË LËNDËN E KONTRATAVE KOLEKTIVE NË ARSIM DHE SHËNDETËSI. **F. 3**



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Macroni në konferencë me Ramën: Shqipëria ka avancuar në rrugën drejt integrimit në BE

Paris, 12 prill - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama gjatë konferencës me presidentin francez u shpreh i emocionuar nga pritja ceremoniale me nderime ushtarake që iu bë gjatë vizitës së tij zyrtare në Francë. Gjatë fjalës së tij, ai kujtoi edhe kohën kur sapo kishte mbërritur në Francë në vitet 1990. "Po vij nga një përvojë e dendur para disa minutash. Një ceremoni që nuk e kisha imagjinuar kurrë në jetën time që u nënshkrua me mbërritjen time në Francë në fillim të viteve '90. Kur vija nga aeroporti mbajta radhën gjatë për të marrë një taksì. Pastaj jetova ato vështirësitë e mëdha të asaj kohe për të gjithë ata dhe ato që vinin nga Shqipëria, sepse Evropa nuk ishte e lehtë për ne në ato kohë. Mendova se kisha parë gjithçka deri mbërrita një ditë I

shoqëruar për të ardhur në këtë pallat për të marrë legjinin e nderit. Por sot jam shumë krenar, jo për veten, por për Shqipërinë, për këtë miqësi. Ishte hera e parë në historinë tonë diplomatike që një përfaqësues i shtetit shqiptar të pritet në këtë mënyrë", tha Rama.

Presidenti i Francës, Emanuel Macron ka përgëzuar Shqipërinë për ecurinë drejt integrimit në BE gjatë konferencës për shtyp që mbajti me kryeministrin Edi Rama. "Ju e dini se mund të keni besim te vendosmëria ime. Dua të përsëris angazhimin e Francës në favor të anëtarësimit të vendit në BE dhe të lëvizjes që ne kemi për Ballkanin Perëndimor. Këtu bëhet fjalë për të vepruar për bashkimin e Evropës, për ta bërë më të fortë. Që prej mbajtjes së konferencës së parë



ndërqeveritare mes BE-së dhe Shqipërisë, Shqipëria ka vazhduar rrugën e saj drejt integrimit. Jemi të impresionuar nga tërësia e

reformave dhe kapacitetet për të avancuar. Përsëhendes zërin e Shqipërisë në rajon dhe skenën ndërkombëtare. Së fundmi pritët

në Tiranë një samit rajonal ku pritët edhe Zelenskyt për të forcuar unitetin me Ukrainën", tha Macron.

ShBA-ja, Koreja e Jugut dhe Japonia mbajnë stërvitje përballë kërcënimeve nga Koreja e Veriut



UASHINGTON, 12 PRILL - Shtetet e Bashkuara, Koreja e Jugut dhe Japonia kanë mbajtur stërvitje të përbashkëta detare në të cilat u përfshi një aeroplanmbajtës amerikan, për të siguruar gatishmëri kundër kërcënimeve bërthamore dhe raketore nga Koreja e Veriut, tha marina e Seulit të premtën.

Koreja e Veriut e ka përsheptuar zhvillimin e armëve dhe javën e kaluar e testoi një raketë hipersonike me lëndë djegëse të ngurtë.

Të mërkurën lideri verikorean Kim Jong Un tha se tani është koha e duhur për të qenë më të përgatitur për luftë se asnjëherë më parë,

duke përmendur gjendjen e paqëndrueshme gjeopolitike.

"Forcat pjesëmarrëse kryen stërvitje luftarake kundër nëndetëseve, për ta përmirësuar reagimin ndaj kërcënimeve nënujore prej Koresë së Veriut, përfshirë prej nëndetëseve dhe prej raketave balistike të shkrepura nga nëndetëset", tha marina e Koresë së Jugut në një komunikatë.

Stërvitjet dyditore, të mbajtura në ujërat ndërkombëtare mes Koresë së Jugut dhe Japonisë të enjten dhe të premtën, sollën së bashku aeroplanmbajtësin Theodore Roosevelt dhe shkatërruesit Howard, Russell dhe Daniel

Inouye, me luftanijet nga fqinjët aziatikë.

Stërvitjet, të cilat kishin për qëllim zhvillimin e aftësive të përbashkëta për t'iu përgjigjur kërcënimeve nga Koreja e Veriut, vijnë pas një plani të përbashkët shumëvjeçar që u përpilua në një samit mes palëve vitin e kaluar, tha Koreja e Jugut. Këto tre vende ushtruan gjithashtu mënyra se si ta bllokojnë transportin e jashtëligjshëm të armëve shkatërruese nga Koreja e Veriut si dhe kryen stërvitje për kërkim-shpëtim.

Ndërkohë, në Uashington, zyrtarët amerikanë dhe ata jugkoreanë mbajtën bisedime vjetore për mbrojtjen të enjten, sipas Seulit.

Izraeli vret një komandant të Hamasit në Bregun Perëndimor

JERUSALEM, 12 PRILL - Dy palestinezë janë vrarë mëngjesin e 12 prillit gjatë përlëshjeve me forcat izraelite në Bregun Perëndimor të pushtuar nga Izraeli, raportuan mjekët palestinezë dhe ushtria izraelite. Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - tha se një nga të vrarët ishte një nga komandantët e tij lokalë. Operacioni izraelit u krye në qytezën Tubas dhe në kampin e refugjatëve al-Fara. Organizata e Gjysmëhënës së Kuqe Palestineze konfirmoi vdekjen e dy personave dhe tha se edhe tre të tjerë janë plagosur, përfshirë njërin që ka

pësuar lëndime serioze.

Ushtria izraelite tha se caku i operacionit ishte Mohammed Daraghme, një komandant lokal i Hamasit. Sipas ushtrisë, Daraghme u vra gjatë shkëmbimit të zjarrit me ushtarët izraelitë të cilët zbuluan armë në veturën e tij. Ushtria pretendoi se Daraghme po planifikonte sulme ndaj caqeve izraelite, por nuk ofroi prova për këtë pretendim.

Përlëshjet që pasuan mes ushtarëve dhe palestinezëve të armatosur rezultuan me vrasjen e palestinezit të dytë. Ushtria izraelite tha se sulmuesit, po ashtu, hodhën eksplozivë drejt



ushtarëve.

Zyrtarët shëndetësorë palestinezë thanë se 460 palestinezë, përfshirë dhjetëra fëmijë dhe adoleshentë, janë vrarë nga Izraeli në Bregun Perëndimor që nga nisja e luftës Izrael-Hamas në Gazë më 7 tetor, që u nxit nga sulmi që Hamasi kreu në jug të Izraelit.

Shumica e të vrarëve në Bregun Perëndimor janë vrarë gjatë konfrontimeve me forcat izraelite, pasi ushtria ka shtuar bastisjet në Bregun Perëndimor në muajt e fundit, duke shënjestuar militantët e dyshuar. Disa palestinezë të tjerë janë vrarë në sulmet e kryera nga kolonët izraelitë.

Çmimet e konsumit, më të larta në marsin e 2024-s se në marsin e kaluar

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 PRILL - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin mars 2024, viti bazë 2015=100. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,3-përqindësh në muajin mars 2024 krahasuar me muajin mars 2023. Inflacioni mujor ishte -0,3 për qind në muajin mars 2024. "Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,3-përqindësh në muajin mars 2024 krahasuar me muajin mars 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pajisjet telefonike dhe të telefaksit (15,6 për qind), pushime të organizuara (14,5 për qind), energjia elektrike (13,2 për qind), pijet alkoolike (10,7 për qind), pemët (9,8 për

qind), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (9,8 për qind), peshqit (9,1 për qind), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (7,8 për qind), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (6,7 për qind), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (6,7 për qind), shërbimet për transport (5,9 për qind), gjërat dhe pajisjet e tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (5,1 për qind), kafja, çaji dhe kakao (5,0 për qind), gazetat, librat dhe materialet për zyra (4,8 për qind), shërbimet rekreative dhe kulturore (4,3 për qind), prodhimet ushqimore (3,8 për qind), kujdesi personal (3,7 për qind), shërbimet financiare (3,7 për qind), mbrojtja sociale (2,8 për qind), duhani (2,7 për qind), shërbimet hoteliere (2,2 për qind), shërbimet ambulatore (2,2 për qind), perimet (1,5 për qind), mishi (1,3 për qind), pajisjet audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave (1,2 për qind), dhe me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve



prej 2,6-përqindësh në IHÇK", thuhet në raportin e ASK-së. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: qumështi, djathi dhe vezët (-5,4 për qind), vajrat dhe yndyrat (-5,0 për qind) dhe karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-0,7 për qind) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,3-përqindësh në IHÇK. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të

konsumit pësoi rënie në një mesatare prej -0,3-përqindësh në muajin shkurt 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: energjia elektrike (-5,7 për qind), shërbimet për transport (-1,8 për qind), këpucë (-1,4 për qind), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-1,0 për qind), qumështi, djathi dhe vezët (-0,9 për qind), perimet (-0,8

për qind), përdorimi i pajisjeve për transport personal (-0,8 për qind), pemët (-0,7 për qind), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (-0,5 për qind), pijet alkoolike (-0,3 për qind) dhe mishi (-0,2 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,4-përqindësh në IHÇK. Ndërsa ngritje e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: veshje (2,3 për qind) me një ndikim prej 0,1-përqindësh në IHÇK.

AKK-ja kërkon nga Gjykata Komerciale ta shqyrtojë lëndën e kontratave kolektive në arsim dhe shëndetësi

PRISHTINË, 12 PRILL - Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës ka kërkuar nga Gjykata Komerciale ta shqyrtojë lëndën e kontratave kolektive në arsim dhe shëndetësi. "Në gusht të vitit 2022, 26 komuna kanë paditur Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe Ministrinë e Shëndetësisë për kthimin e mjeteve financiare të marra padrejtësisht nga komunat për zbatimin e Kontratave Kolektive në arsim dhe shëndetësi. Deri në gusht të vitit 2022 komunave u janë marrë mbi 35 milionë euro. Marrja e mjeteve është duke vazhduar. Këto padi janë bërë në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe të bartura për shqyrtim në Gjykatën Komerciale në Prishtinë. Siç dihet, këto dy ministri në mënyrë të njëanshme patën lidhur marrëveshje me sindikatat respektive për zbatim të Kontratave Kolektive pa asnjë



konsultim me komunat e Kosovës. Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës rithekson se nuk është kundër Kontratave Kolektive, por është kundër

zbatimit të tyre në formën e deritashme duke ua marrë mjetet financiare komunave kur palë nënshkruese janë institucionet qendrore", ka njoftuar AKK-ja.

Sipas këtij njoftimi, këto dy kontrata janë nënshkruar pa asnjë konsultim paraprak me komunat, pa vlerësim të ndikimit buxhetor, pa dakordim me komunat dhe pa

dijësinë e komunave, derisa obligimet financiare të tyre kanë rënë tërësisht mbi komunat dhe buxhetet e tyre. "Andaj me këtë rast Bordi i Asociacionit të Komunave kërkon nga Gjykata Komerciale t'i shqyrtojë këto lëndë sa më shpejt me që dëmi në autoritetet lokale është i përditshëm dhe në dëm të investimeve të projekteve kapitale, e që vetëm këtë vit pritet ta tejkalojnë shumën prej 30 milionë eurosh. Në zbatim të këtyre marrëveshjeve përmburuesit po ua marrin mjetet komunave kryesisht nga fondi i Investimeve të Projekteve Kapitale. Pra këto mjete do të duhet të përktheheshin në projekte kapitale për qytetarët derisa qeveria as nuk rimbursion këto mjete te komunat e as nuk lejon ato që t'i fusin në planifikimet buxhetore", ka theksuar AKK-ja.

IKShPK-ja: Rriten rastet me kollën e mirë

PRISHTINË, 12 PRILL - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se ka regjistruar raste të reja me sëmundjen ngjitëse të kollës së mirë, apo siç njihet ndryshe edhe si pertussis. "Gjatë vitit 2024 IKShPK-ja ka regjistruar 14 raste të konfirmuara të pertussisit, kryesisht te moshat e reja, që paraqet një rritje të lehtë krahasuar me vitet paraprake", është bërë me dije në njoftimin për medie. Më 29 mars ky institut kishte

raportuar për tetë raste të regjistruara me kollën e mirë. "Kjo sëmundje ngjitëse mund të shfaqet në çdo moshë, por më shpesh i prek fëmijët dhe adoleshentët. Më të rrezikuar janë fëmijët nën moshën njëvjeçare", ka njoftuar IKShPK-ja. Kjo sëmundje, që shkaktohet nga bakteri bordetella pertussis, përhapet lehtësisht nga personi në person përmes spërklave nga kollitja ose teshtitja e personit të infektuar. Sipas IKShP-së,

simptomat zakonisht shfaqen shtatë deri në dhjetë ditë pas infektimit, por mund të shfaqen edhe deri në 21 ditë më vonë. Simptomat janë të ngjashme me ftohjen e zakonshme, përfshirë teshtitjen, rrjedhjen e hundës, temperaturë të ulët dhe një kollë të lehtë. Sipas IKShPK-së, mënyra më e mirë e parandalimit të kësaj sëmundjeje është vaksinimi, duke u bërë thirrje prindërve t'i vaksinonjë fëmijët dhe foshnjat për këtë sëmundje ngjitëse.





Pse është i rëndësishëm regjistrimi i popullsisë?

PRISHTINË, 12 PRILL - "A ishin te ti për regjistrim?", "sa zgjati procedura?", "çfarë pyetjesh patën?" - këto janë vetëm disa prej copëzave të muhabetëve që po bëhen ditët e fundit në lidhje me regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë.

Procesi, që realizohet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), ka nisur më 5 prill dhe do të zgjasë deri më 17 maj.

Të gjithë janë të obliguar t'i përgjigjen pothuajse secilës pyetje sepse, në të kundërtën, mund të gjobiten - individët nga 30 deri në 2 000 euro, kurse bizneset deri në 20 000 euro.

Shteti dhe individët përfitojnë prej regjistrimit në disa aspekte:

Demografia

Përmes regjistrimit shteti e ka parasysh shtrirjen e popullatës nëpër komuna dhe vendbanime. Kështu ka thënë Bekim Salihu nga Instituti për Studime të Avancuara - GAP në Prishtinë në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë". "Komunat marrin buxhet edhe nga qeveria, përveç të hyrave vetjake, dhe njëra prej formave se si ndahet buxheti nëpër komuna është formula bazuar në numrin e popullsisë. Nëse një komunë del që ka rënie të madhe të popullsisë,

padysim që ajo do të reflektohet që nga viti i ardhshëm në buxhetin e asaj komune".

Nga ndarjet buxhetore, më pas, reflektohen investimet kapitale dhe kapaciteti i një komune për t'i kryer punët e parapara.

Situata ekonomike

Gjendja reale mbi lëvizjet brenda shtetit mund të jetë efektive për qytetarët edhe në krijimin e një ideje mbi mundësitë që kanë para vetes.

"Këto janë lëvizje kryesisht të natyrës ekonomike. Kjo mund të tregojë për një individ se cili vend është më i përshtatshëm për të lëvizur, nëse dëshiron të ketë një punë të caktuar, ose një të ardhme të caktuar brenda një profesioni të caktuar", ka thënë Arian Lumezi prej Institutit për Politika Sociale "Musine Kokalari" në Prishtinë, në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas Lumezit, që nga regjistrimi i fundit i popullsisë më 2011 kanë ndodhur shumë ndryshime - pandemia e koronavirusit, pasojat e luftës së Rusisë në Ukrainë, liberalizimi i vizave - andaj është e domosdoshme një pasqyrë më e mirë e trendëve ekonomikë.

Lumezi ka thënë se të dhënat e reja do të tregojnë më shumë edhe për

standardin e jetës në Kosovë: "Ka një paqartësi se çfarë quajmë rritje të pagës, raportit me inflacionin, rritjen e çmimeve e të tjera".

Ai beson se për qytetarët është shumë e rëndësishme të kuptohet nëse ka pasur inflacion të mirëfilltë apo të manipulueshëm me qëllim të rritjes së çmimeve.

Gjendja e komuniteteve

Hulumtuesit besojnë se është shumë e rëndësishme që të kuptohet më shumë për gjendjen e minoriteteve në Kosovë.

Sipas regjistrimit të fundit më 2011, 91 për qind e banorëve të Kosovës janë shqiptarë, 3,4 për qind janë serbë, ndërsa 5,6-përqindëshi tjetër përbëhet nga boshnjakët, goranët, turqit, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët.

Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, u ka bërë thirrje serbëve të mos marrin pjesë në regjistrimin e sivjetmë të popullsisë në Kosovë sikurse më 2011.

Salihu dhe Lumezi besojnë se regjistrimi do të ndihmonte në nxjerrjen e një pasqyre të qartë dhe të kontekstit në të cilin jetojnë minoritetet në Kosovë, në veçanti serbët në pjesën veriore. "Qarkullojnë fjalë që në veri jetohej shumë më mirë sesa në

pjesët e tjera të Kosovës, sepse atje njerëzit nuk kanë paguar rrymë. Këto gjëra, në përgjithësi, nuk qëndrojnë, pasi, nëse shkon vetë, e shoh që jeta nuk është ashtu si paraqitet, dhe nuk lidhet gjithçka me të ardhurat apo pensionet", ka thënë Lumezi.

Sipas të dhënave zyrtare, numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë është rreth 1.8 milion, prej të cilëve rreth 25 000 janë serbë. Megjithatë, sipas vlerësimeve të organizatave joqeveritare serbe në Kosovë, në këtë vend jetojnë rreth 100 000 pjesëtarë të komunitetit serb.

Dëmet e luftës

Për herë të parë, në kuadër të regjistrimit, është përfshirë edhe një formular për regjistrimin e dëmeve që u janë shkaktuar ekonomive familjare gjatë luftës. Salihu, ndonëse e mirëpret nismën, beson se do të ishte më mirë që "kjo të bëhej më 2011, për shkak që po ndryshojnë gjeneratat, e kujtesa dhe shumë gjëra mund të harrohen".

Autoritetet në të kaluarën kanë thënë se vlera e dëmeve ekonomike që Serbia ia ka shkaktuar Kosovës në luftën e viteve 1998-'99 është rreth 22 miliardë euro, mirëpo të dhëna

publike nuk ekzistojnë.

Kush do t'i përdorë të dhënat?

Përveç autoriteteve shtetërore, një pjesë të të dhënave do të mund t'i përdorin edhe hulumtuesit, mediat, academia, e organizatat joqeveritare dhe ato ndërkombëtare, për përpilim të raporteve të ndryshme.

ASK-ja ka paralajmëruar që rezultatet preliminare të regjistrimit do t'i publikojë brenda tre muajve.

Të gjitha informacionet që japin qytetarët janë të fshehta dhe është shumë e rëndësishme që informacionet të jepen të sakta.

Si Salihu, ashtu edhe Lumezi, besojnë se autoritetet nuk kanë bërë mjaftueshëm për vetëdijesimin e popullsisë për rëndësinë e këtij procesi, prandaj disa qytetarë kanë dilema rreth regjistrimit. "Këto të dhëna nuk mbliidhen për qëllime të tatimit, por bëhen me qëllim të studimit... nuk do të thuhet, shembull, Bekimi i ka 10 prona, por thuhet se Prishtina i ka 10 prona. Merret tërësia dhe jo veçantia", ka shpjeguar Salihu.

ASK-ja ka thënë se regjistrimin po e zhvillon në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, dhe se një ekip i Brukselit do ta vëzhgojë procesin, ndërsa në fund edhe do ta vlerësojë atë.

Sarrazin: Gjermania nuk përkrah ndonjë formë të Asociacionit që minon integritetin e Kosovës

I dërguari i posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka bërë me dije se Gjermania nuk përkrah ndonjë formë të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe që minon integritetin e Kosovës. Megjithatë, ai ka theksuar se moskrijimi i një bashkësie të komunave me shumicë serbe e pengon rrugën e Kosovës drejt BE-së. Ai u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i kryejnë obligimet e dalë nga procesi i dialogut

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 PRILL - Tri javë pas vizitës së fundit në Kosovë, emisari i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka ardhur në një tjetër vizitë të paparalajmëruar në Prishtinë.

Zhvillimet e fundit në veri thotë se e sollën sërish këtu, derisa për to dhe Asociacionin, i dërguari i kancelarit gjerman për Ballkanin Perëndimor, ka diskutuar në një takim me gazetarët. Për Asociacionin dhe mundësinë që mosthemelimi i tij të bëhet pengesë për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, diplomati gjerman tha se shteti i tij ende nuk ka një qëndrim. "Qeveria gjermane nuk ka ende qëndrim për raportin e Bokayanis, është procedura tutje e votimit të Këshillit dhe pastaj do t'i marrim të gjitha në konsideratë. Por, ju e thatë ka lidhje dhe Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe është përmendur si çështje dhe ne do ta konsiderojmë atë, por Qeveria e Gjermanisë ende nuk ka pozicion për këtë", ka thënë Sarrazin.

Gjatë këtij bashkëbisedimi,

Sarrazin tha se e konsideron tani kohën e duhur që të vazhdohej tutje hapat për krijimin e Asociacionit. "Të gjithë e dinë se shumë vende mosnjohëse brenda BE-së shikojnë kah Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, por unë nuk mund t'ju them se çfarë ato do të bëjnë nëse kjo kryhet ose jo sepse nuk është puna ime. Gjermania njihet Kosovën, por edhe ne jemi të bindur se kjo është gjëja e duhur të bëhet, veçanërisht tani dhe të shkohet tutje. Mund të llogarisni në Gjermaninë. Ne kurrë nuk do të përkrahim ndonjë formë të Asociacionit që minon integritetin e Kosovës. Por, moskrijimi i Asociacionit nuk çon drejt BE-së", ka shtuar Sarrazin. Gjatë vizitës, Sarrazin ka takuar presidenten Vjosa Osmani, kryeministrin Kurti, shoqërinë civile dhe Listën Serbe. Nga takimi me Listën Serbe thotë se nuk doli me ndonjë ide të qartë se si ky subjekt serb mund të tërhiqet nga vendimi për të bojkotuar votimin për shkarkimin e kryetarëve të komunave veriore më 21 prill. "Ky takim nuk më dha shenja të qarta të cilat do të më jepnin idenë se cili do të ishte kompromisi", ka shtuar emisari gjerman.



Por, i pyetur rreth lobimit të Serbisë për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në KiE, diplomati gjerman refuzoi të vlerësojë cila palë po e shkel atë, por e ka të qartë se një gjë të tillë nuk e lejon marrëveshja mes palëve. "Unë nuk jam në pozitën e referit që të vendos kush po e shkel marrëveshjen e kush jo. Por, sipas pikëpamjes sime dhe asaj si e lexoj marrëveshjen e Ohrit, Serbia nuk duhet ta pengojë Kosovën në anëtarësim në organizata ndërkombëtare", ka thënë më tej Sarrazin. Për marrëveshjen, Sarrazin shtoi se të dyja shtetet duhet t'i kryejnë obligimet e tyre.

Edhe ambasadorët e vendeve më të industrializuara Quint-it, ku bëjnë pjesë Franca, Gjermania,

Italia, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara, por edhe zyra e BE-së i kërkuan Listës Serbe të tërhiqet nga vendimi për bojkotim të zgjedhjeve të 21 prillit në veri të Kosovës me të cilat parashihet shkarkimi i kryetarëve shqiptarë. "Na vjen keq për deklaratat e Listës Serbe dhe aktorëve të tjerë politikë serbë të Kosovës që bëjnë thirrje për tërheqje nga pjesëmarrja në këtë votim për tërheqjen e kryetarëve. Pjesëmarrja demokratike është thelbësore për të siguruar që institucionet e zgjedhura të jenë përfaqësuese të popullatave të cilave u shërbejnë. Votimi është një liri kritike e shoqërive demokratike", thuhej në deklaratën e Quint-it.

Më tej thuhet se zgjedhjet e 23

prillit të vitit 2023, kur me një pjesëmarrje të ulët në votime u zgjodhën kryetarët shqiptarë, "nuk dhanë zgjidhje politike afatgjatë për këto komuna dhe se qeverisja përfaqësuese në veri do të rikthehet kur të mbahen zgjedhjet për kryetarë komunash me pjesëmarrjen aktive të të gjitha komuniteteve". Pavarësisht prej thirrjeve të Listës Serbe për bojkotim të zgjedhjeve, votimi për shkarkimin ose jo të kryetarëve shqiptarë do të mbahet më 21 prill në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Në këtë kuadër Quint-i i bën thirrje Qeverisë së Kosovës "të jetë e përgjegjshme ndaj shqetësimeve të qytetarëve të saj dhe të veprojë me profesionalizëm gjatë gjithë këtij procesi".

Prokuroria ngre aktakuzë kundër një kosovari për "krim kundër njerëzimit" në Siri dhe Irak

PRISHTINË, 12 PRILL - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër një shtetasi të Kosovës të premtën, të cilin e akuzon për kryerje të "krimit kundër njerëzimit" në Siri dhe në Irak gjatë një periudhe trevjeçare nga viti 2014 deri më 2017. Në një komunikatë për medie të premtën, Prokuroria tha se i dyshuari me iniciale M. D., ngarkohet gjithashtu për kryerjen e veprës penale "shkelje e rëndë e ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar".

I dyshuari, i cili po mbahet në paraburgim, akuzohet se krimin e kishte kryer kundër vajzave dhe grave të komunitetit jezidi gjatë



konfliktit në Siri dhe në Irak gjatë viteve 2014-2017.

Në vitin 2015 Kosova e futi në fuqi një ligj i cili e ndalon pjesëmarrjen në luftëra të huaja -

i cili parasheh dënime deri në 15 vjet burgim për të akuzuarit.

Në një raport në dhjetorin e kaluar, Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) e kritikoi Kosovën

për dënime të ulëta për akuzat e lidhura me terrorizëm. DASH tha se në Kosovë gjatë vitit 2022 institucionet e drejtësisë vazhduan të shqiptonin dënime të ulëta për akuzat e lidhura me terrorizmin, dhe tha se ka edhe lirime të parakohshme për këto akuzat.

Për disa vjet me radhë prej vitit 2011, më shumë se 350 shtetas të Kosovës udhëtuan drejt Sirisë dhe Irakut. Është thënë se shumica prej tyre janë rreshtuar përkrah grupit militant Shteti Islamik.

Në prill të vitit 2019 Kosova i ktheu 110 shtetas nga Siria, në mesin e të cilëve katër luftëtarë të Shtetit Islamik, 32 gra dhe 74 fëmijë, ndërsa në korrik të vitit

2021 autoritetet kanë riatdhesuar edhe 11 shtetas nga Siria.

Sipas të dhënave të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), të publikuara në mars të vitit 2023, "shumica e të kthyerve, me të arritur në Kosovë, janë arrestuar dhe u janë nënshtruar proceseve gjyqësore kundër tyre". Sipas QKSS-së, një pjesë e tyre tashmë e kanë vuajtur dënimin në burg por, duke marrë parasysh "nivelin e rrezikshmërisë që këta individë dhe kauza të cilën ata e përkrahën, paraqesin për sigurinë kombëtare të Kosovës dhe aleatëve të saj, institucionet e Kosovës obligohen ta monitorojnë procesin e ndjeshëm të rehabilitimit të tyre dhe rikthimit në komunitet".

Gjilani, punë praktike me pagesë për moshat 16-24 vjet

GJILAN, 12 PRILL - Komuna e Gjilanit edhe këtë vit do ta vazhdojë programin e punës praktike të nxënësve dhe studentëve në institucionet

komunale. Kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, ka zhvilluar takime të ndara me Këshillin e Nxënësve të Gjilanit dhe

studentët e Universitetit "Kadri Zeka". "Njoftuam të rinjtë për programin që mundëson tre muaj praktikë në institucionet lokale me

pagesë. Jemi një hap më tutje drejt fuzionimit të mësimi teorik me praktikën", ka thënë kryetari Hyseni.



Projektligji për tekstet shkollore procedohet për shqyrtim nen për nen

PRISHTINË, 12 PRILL - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, nën udhëheqjen e kryetarit Ardian Gola, mbajti mbledhjen e radhës, në të cilën u shqyrtua Projektligji nr.08/L-207 për tekste shkollore.

Referuar projektligjit në fjalë, kryetari Gola tha se pas kalimit të tij në lexim të parë, në përputhje me vendimin e kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca, komisioni gjegjë e ka proceduar tutje për shqyrtim nen për nen, me ç'rast ka formuar grupin punues për shqyrtim më të hollësishëm.

Sipas procedurës dhe praktikës parlamentare, e ftuar në këtë mbledhje ishte ministrja e Arsimit, Arbërie

Nagavci.

Prezantimin e punës së grupit punues, përfshirë këtu amendamentet e dala nga po i njëjti, lidhur me Projektligjin për tekstet shkollore, e bëri kryesuesja e grupit, deputetja Arijeta Rexhepi. Kryesuesja Rexhepi fillimisht theksoi se në këto amendamente, gjithsej 11, janë diskutuar dhe përfshirë, po ashtu, edhe propozimet që janë gjatë dëgjimit publik, për të vazhduar më pas në shqyrtim të secilit prej amendamenteve veç e veç.

Meqë pas prezantimit të amendamenteve anëtarët e komisionit nuk shtuan asgjë, unanimisht u votuan të gjitha prej tyre dhe projektligji së bashku me to u procedua për shqyrtim te komisionet e përhershme parlamentare.



Parku i Biznesit Drenasi II, afër finalizimit



DRENAS, 12 PRILL - Në Drenas është mbajtur debati i radhës lidhur me procedurat drejt jetësimit të Parkut të Biznesit II, ku përfaqësuesit nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me përfaqësues nga komuniteti i biznesit, qytetarë dhe aktorë të jetës publike në Drenas, kanë dhënë komentet e tyre mbi Strategjinë e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si një hap tjetër drejt

plotësimit të dokumentacionit rreth finalizimit të Parkut të Biznesit Drenasi II.

Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Petrit Gashi dhe përfaqësuesi nga MINT, Nol Buzhala, i informuan të pranishmit për vazhdimin e procedurave dhe kohën e fillimit të punimeve në Parkun e Biznesit. Ata kërkuar nga të gjithë të interesuarit që deri më 20 prill t'i dërgojnë komentet e

tyre lidhur me Strategjinë e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis si një hap tjetër që komuna e Drenasit dhe MINT të vazhdojnë tutje jetësimin e këtij projekti me rëndësi për komunën e Drenasit dhe ekonominë e Kosovës.

Në nëntor të vitit të kaluar është mbajtur debati i parë publik me qytetarë, biznese, grupe të interesit, ku janë njoftuar të pranishmit për krijimin e Parkut Industrial 2 në Drenas.

Ligji i ri i trafikut, policia në Ferizaj njofton se ka shqiptuar 1 430 gjoba

FERIZAJ, 12 PRILL - Që nga hyrja në fuqi e Ligjit të ri për trafikun rrugor, policia rajonale e Ferizajt ka shqiptuar 1 430 gjoba për kundërvajtje. Në njoftimin për media thuhet se shumica e gjobave kanë qenë për tejkalim të shpejtësisë. "Tejkalim i shpejtësisë, 500 gjoba; përdorimi i telefonit gjatë ngasjes, 103 gjoba; mospërdorimi i rripit të sigurisë, 65 gjoba; Xhamat e errët, vendosja e foljes ose materialit tjetër, 61 gjoba; Skadimi i afatit të regjistrimit të automjetit, 43 gjoba; Drejtimi i

mjetit pa patentë shofer, 38 gjoba; Mjetet pjesëmarrëse në trafik pa sinjalizim të duhur ndriçues, 11 gjoba; Kundërvajtje ndaj motoçiklistëve, 9 gjoba; Kycja e pa rregullt në rrugën kryesore, 9 gjoba; Tejkalim në vijë të plotë, apo vend të ndaluar, 3 gjoba dhe të tjera, 588 gjoba", ka njoftuar Policia e Kosovës. Policia Rajonale e Ferizajt do të vazhdojë aktivitetet e shtuara, me synim parandalimin e aksidenteve në komunikacionin rrugor dhe u bënë thirrje shoferëve të bëjnë kujdes.



Hapet Qendra Françeskane për Rini dhe Kulturë pranë Kishës Katolike në Gjakovë

GJAKOVË, 12 PRILL - Kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, bashkë me drejtorin për Zhvillim Ekonomik, Ferdinand Kolaj, ishin të pranishëm në hapjen e

Qendrës Françeskane për Rini dhe Kulturë pranë Kishës Katolike në Gjakovë.

Po në këtë hapësirë u promovuan dy libra nga Fra Lovro Gavran.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryetari Gjini u shpreh i lumtur për hapjen e kësaj qendre e cila do të shërbejë për zhvillimin e shumë aktiviteteve kulturore

dhe rinore. E librat të cilët u promovuan do ta pasurojnë bibliotekën e kësaj qendre, por edhe do të jenë dokumente të rëndësishme për historinë e Gjakovës.



Kurti vlerëson lart kontributin pozitiv të OSBE-së për promovimin e qeverisjes demokratike në Kosovë

PRISHTINË, 12 PRILL - Kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim ministrin e Punëve të Jashtme, Çështjeve Evropiane dhe Tregtisë të Maltës, Ian Borg, në kuadër të vizitës së tij në vendin tonë në cilësinë e kryesuesit të OSBE-së. "Kosova e vlerëson lart kontributin e vazhdueshëm pozitiv të OSBE-së në promovimin e

qeverisjes demokratike në Kosovë si dhe rëndësinë e fuqizimit të bashkëpunimit tonë dhe rritjes së mbështetjes në forcimin e institucioneve tona, në sundim të ligjit, të drejta të njeriut dhe liri të medieve mes shumë të tjerash", ka thënë Kurti.

Ai ka treguar se me Borg biseduan për mënyrat se si

mund të bëjnë më shumë në lidhje me projektet e dyanshme, duke pasur vlera dhe qëllime të përbashkëta. Kurti ka theksuar se duke nënvizuar veçantinë e kësaj vizite të tij në Kosovë, e cila kontribuon në thellimin e marrëdhënieve tona, e ka falënderuar ministrin Borg për bisedën e frytshme dhe pikëpamjet e ndara.



UP-ja reagon për rastet e ngacmimeve: Palët të përmbahen nga çfarëdo presioni, rastet duhet të trajtohen me seriozitet

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 PRILL - Universiteti i Prishtinës përmes një reagimi publik ka shkruar për denoncimet e paraqitura ndaj profesorit Xhevat Krasniqi, i cili po akuzohet nga disa studente për ngacmim seksual. "Bazuar në informatat e ofruara nga Këshilli i Etikës, në lidhje me denoncimin e paraqitur ndaj prof. Xh. K., dhe procedurat dhe standardet që ky Këshill zbaton, Universiteti i Prishtinës sqaron si në vijim: Si për çdo rast, edhe në rastin në fjalë, Këshilli i Etikës zhvillon procedurat e përcaktuara dhe të zbatueshme ligjore, përfshirë në mënyrë të posaçme procesin e përcaktuar në Rregulloren përkatëse të UP-së për procedurat dhe masat disiplinore. Rasti në fjalë nuk ka përbërë përjashtim nga ky

rregull. Sqarojmë se rasti i adresuar pretendohet të ketë ndodhur para një viti e gjysmë (tetor/nëntor 2022, dhe janar/shkurt 2023). Përkundër kësaj, rasti është adresuar në Këshill të Etikës vetëm në mes të marsit 2024. Kurdo që një rast paraqitet, ai merret dhe trajtohet me seriozitetin e duhur dhe procedurat e paracaktuara, por nëse është dashur kaq kohë e gjatë për ta paraqitur, Këshilli vlerëson se meriton një hapësirë kohore, që gjithsesi është shumë më e arsyeshme se kjo më sipër, për të punuar u lirë dhe, mbi të gjitha, për t'u siguruar që dëgjon dhe shqyrton deklarinimin e secilës palë, të përfshirë në këtë çështje dhe që duhet dëgjuar. Në këtë drejtim, Këshilli vlerëson që nuk ka as vend dhe as arsye për dramatisim të situatës", thuhet në reagimin e UP-së.

Më tej theksohet se përkundrejt

konsideratave të mësipërme, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit, Këshilli i Etikës ka pranuar ta trajtojë këtë rast me urgjencë, gjë që është duke e bërë. "Mbi këtë bazë, Këshilli deri më tani ka mbajtur tri seanca, të cilat janë zhvilluar me qëllim dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar nga vetë pala denoncuese. Dëgjimi i dëshmitarëve nga pala denoncuese është hap procedural i domosdoshëm, për të shmangur një rezultat të kontestueshëm dhe për të dhënë garancinë se për rastin është gjykuar e vendosur drejt. Në një rend demokratik dhe sistem që udhëhiqet nga sundimi i ligjit, Këshilli i Etikës kujdeset që të shmangët arbitrariteti, duke ju mundësuar palëve në procedurë të drejtën e tyre për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur pretendimet e tyre në mënyrë të plotë e të

barabartë. Kjo pasi parimi themelor për një proces të drejtë, të paanshëm dhe objektiv vlen edhe për rastet e shqyrtuara nga Këshilli i Etikës. Pretendimet janë serioze dhe kjo gjithashtu nënkupton se edhe rasti duhet të trajtohet me seriozitet. Secili pretendim dhe secila provë duhet të shqyrtohet, brenda një kohe të arsyeshme, duke bërë përpjekje maksimale që ky rast të vendoset brenda një periudhe sa më të shpejtë të mundshme dhe objektivisht optimale, gjithmonë duke u siguruar se nuk dëmtohet drejtshmëria e vendimit", thuhet në reagim.

UP-ja ka njoftuar se në kuadër të trajtimit të paanshëm dhe objektiv, është e domosdoshme që të gjitha palët të përmbahen nga çfarëdo mjeti e forme presioni. Këshilli i Etikës ka refuzuar dhe do ta refuzojë presionin si modalitet të

funksionimit të tij, sepse një gjë e tillë është në interesin më të mirë të funksionimit institucional dhe të rendit juridik, në përputhje me standardet më të mira evropiane dhe ndërkombëtare. "Sigurisht, Këshilli i Etikës, sikurse vetë Universiteti i Prishtinës, e kupton dhe pranon të drejtën e protestës, por u bën thirrje të gjitha palëve të përfshira, si dhe palëve të treta, që protestat të zhvillohen në mënyrë demokratike, në një mënyrë që nuk ushtron presion dhe nuk pengon kryerjen e detyrave të Këshillit të Etikës. UP iu rikujton të gjitha palëve që, ndonëse vendimet e Këshillit të Etikës janë të rëndësishme, ato nuk paraqesin vendime të formës së prerë. Prandaj, secila palë gëzon të drejtën për t'i adresuar pretendimet edhe në instanca të tjera, përfshirë ato gjyqësore", thuhet, ndër të tjera, në reagimin e UP-së.

50 euro gjobë për këmbësorët që kalojnë rrugën jashtë vendkalimeve të shënuara

PRISHTINË, 12 PRILL - Nga data 3 prill ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Rregullat e Trafikut Rrugor. Kalimi i rrugës jashtë vendkalimeve të shënuara për këmbësorë apo kalimeve të veçanta mund të bëhet vetëm në rastet kur vendkalimi më i afërt për

këmbësorë është më larg se pesëdhjetë (50) metra në vendbanime dhe më larg se njëqind (100) metra jashtë vendbanimeve.

Mosrespektimi i kësaj rregulle ndëshkohet me gjobë prej 50 eurosh. "Këmbësorë! Mos përdor

telefonin, dëgjueset në veshë apo pajisjet e tjera të ngjashme që mund t'ju hutojnë!

Shfrytëzo vendkalimin për këmbësorë dhe ec në trotuar! Në rrugët pa trotuare, ec në anën e majtë! Kujdesi shpëton jetë!", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Hapet Panairi i Turizmit në Prishtinë

PRISHTINË, 12 PRILL - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se kishte kënaqësinë të jetë pjesë e hapjes së Panairit të

Turizmit, një ngjarje shumë e rëndësishme që do të mbahet për dy ditë në Pallatin e Rinisë, e cila edhe shënon fillimin e një kapitulli të ri për

turizmin në vend. "Kjo është një mundësi fantastike për të shfaqur dhe parë bukuritë dhe mundësitë që ofron kryeqyteti ynë e Kosova jonë.

Ftoj të gjithë qytetarët dhe vizitorët të zbulojnë dhe të përjetojnë mrekullitë që na rrethojnë", ka thënë kryetari Rama.



Banka Qendrore Evropiane nuk ndryshon normat e interesit

FRANKFURT, 12 PRILL - Banka Qendrore Evropiane për të pestën herë me radhë nuk ka ndryshuar normat e interesit pavarësisht rënies së inflacionit. Banka, me seli në Frankfurt, gjatë mbledhjes për politikën monetare, ruajti normën bazë të rifinancimit, që ofrojnë likuiditet për sistemin bankar, në 4.5 për qind. Edhe norma e depozitave mbeti e pandryshuar në 4 për qind.

Ekonomistët gjerësisht presin që të ketë ulje të normave të interesit në qershor.

Presidentja e Bankës Qendrore Evropiane, Christine Lagarde, shtoi shpresat për këtë gjë, duke thënë se ulja e normave të interesit mund të ndodhë së shpejti, nëse vazhdon trendi i rënies së inflacionit. "Do të ishte e përshtatshme të reduktohej niveli aktual i politikave kufizuese monetare" nëse inflacioni afrohet drejt cakut prej 2-përqindësh të Bankës Qendrore Evropiane, tha ajo në një konferencë për medie.

Në qershor ekspertët e Bankës Qendrore Evropiane priten t'i paraqesin parashikimet e reja ekonomike dhe të inflacionit. Në mënyrë që të luftohet inflacioni, i cili arriti në nivele rekorde pas



nisjes së pushtimit rus të Ukrainës, Banka Qendrore Evropiane rriti dhjetë herë resht normat e interesit që nga korriku i vitit 2022. Kjo bën që kreditë të jenë më të shtrenjta, të ulet

kërkesa dhe kështu të luftohet niveli i lartë i inflacionit. Por, në të njëjtën kohë, rritja e normave të interesit krijon një barrë më të rëndë për ekonominë dhe individët që duan të marrin hua.

Së fundi, inflacioni në Eurozonë ka rënë dhe pritet të vazhdojë të bjerë.

Çmimet e konsumit u rritën për 2.4 për qind në mars krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të

kaluar, thuhet në vlerësimet paraprake. Inflacioni është 2.6 për qind në shkurt, ndërkaq në janar ishte 2.8 për qind. Në mars të vitit 2023 inflacioni ishte 6.9 për qind.

'Secontec' shpreh interesim për investim në zhvillimin e teknologjisë në industrinë e mbikëqyrjes në Kosovë



PRISHTINË, 12 PRILL - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka mbajtur një takim të rëndësishëm me përfaqësuesin e Shoqatës Ndërkombëtare të Operacioneve të Stabilitetit (ISOA), Tobias Beutgen dhe përfaqësuesin e kompanisë "Secontec", Romuald Kowalik.

Gjatë këtij takimi Kowalik ka paraqitur profilin e kompanisë gjermane "Secontec" dhe shprehi interesimin për investime në zhvillimin e teknologjisë në industrinë e mbikëqyrjes në Republikën e Kosovës.

Ministria Hajdari paraqiti kornizën legislative të miratuar gjatë viteve të fundit dhe përparësitë për investitorët e huaj në ambientin e favorshëm për të

bërit biznes në Kosovë, përmes të cilave ofrohet mbështetje dhe kujdes për investitorët vendorë dhe të huaj, me lehtësirat e krijuara për investime në vendin tonë.

Pas shkëmbimit të ideve interesante gjatë këtij takimi, Kowalik shprehu zotimin e tij për hapat e ardhshëm në vlerësimin e krijimit të një qendre operative në vendin tonë, në fushën e video-mbikëqyrjes në distancë.

"Secontec" është një nga kompanitë lidere në fushën e video-mbikëqyrjes në distancë, me përdorimin e vazhdueshëm të inteligjencës artificiale (AI) në identifikimin dhe filtrimin e alarmeve. Falë kësaj njohurie digjitale, "Secontec" është lidere e teknologjisë në Gjermani në industrinë e mbikëqyrjes.

Më 18 prill do të mbahet ankandi i pestë i letrave me vlerë për vitin 2024

PRISHTINË, 12 PRILL - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 18 prill do të mbahet ankandi i pestë për vitin

2024. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet dyvjeçar në shumën prej 20 milionë eurosh.

Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, ku

interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (2 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (18)



Prof. dr. Sabit SYLA &
Prof. dr. Hamit KABA

-92-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i
Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
2 shtator 1981
I nderuar Charles,

Kosova: përgatitjet për vitin e ri shkollor

Përmbledhje

1. Autoritetet e Kosovës janë përgatitur shumë për vitin e ri shkollor që filloi sot (Universiteti i Prishtinës rihapet në tetor). Vëmendje e veçantë i është kushtuar në Kosovë, por edhe në Mal të Zi dhe në Maqedoni përbajtjes së teksteve shkollore në gjuhën shqipe; shumë libra janë konstatuar se përmbajnë paragrafe me tone nacionaliste dhe për rrjedhojë janë tërhequr nga përdorimi. Është kërkuar që të vihen para përgjegjësive personat përgjegjës për shqyrtimin e këtyre teksteve shkollore dhe pranimin e tyre, por që deri tani pa sukses. Por autoritetet jugosllave vazhdojnë t'i japin shumë rëndësi rifillimit të qetë të mësimin.

Detaje

2. Siç kam raportuar (në letrën time për ju të datës 23 korrik), autoritetet në Kosovë kanë shfrytëzuar pushimet verore për të shqyrtuar sistemin arsimor në Krahinë dhe për të futur një larmi ndryshimesh. Meqenëse është afruar data e planifikuar për rifillimin e mësimin, shtypi ka vëzhguar nga afër (nëse jo në mënyrë të përsëritur) zhvillimet në këtë krahinë të rëndësishme; përmbledhja e mëposhtme është marrë nga përshkrimi i ngjarjeve në gazetën "Politika", përveç kur shprehej ndryshe.

3. Në një fjalim madhor të Komitetit Qendror të LKK më 6 gusht, Sekretari i Kryesisë, Peter Kostiq, identifikoi katër detyra të gjera arsimimi në Kosovë: nevojën për diferencim në radhët e kuadrove të përfshirë në arsim për të përjashtuar të gjithë ata që nuk kishin "cilësitë e duhura moralopolitike" apo që kishin prirje nacionaliste; heqjen e "një numri të madh njerëzish të pakualifikuar"; nevojën për të mbushur këto hapësira me kuadro të përgjegjshëm; si dhe një shqyrtim analitik dhe kritik të bazës ideologjike të programeve shkollore dhe, në veçanti, teksteve shkollore. Megjithatë këto objektiva pa dyshim janë ndjekur

pak a shumë me kujdes, gjatë muajit të fundit shtypi ka nxjerrë së paku disa të dhëna që tregojnë se në jetën akademike të Krahinës po zëvendësohet "një numër i madh njerëzish të pakualifikuar". Mbase suksesi në këtë front do të përmbushë përpjekjet e Z. Rushi për t'i dhënë fund praktikave shkel e shko dhe jokompetente mësimdhënëse në Universitetin e Prishtinës. Por analiza e fundit e përbajtjes së teksteve shkollore ka qenë vërtet domethënëse. Tekstet shkollore

4. Historia kryesore në Kosovë për këtë çështje ka qenë refuzimi i plotë i një vlerësimi të mëparshëm nga Komiteti përgjegjës i Këshillit të Arsimit të Kosovës që tekstet shkollore aktualisht në përdorim, janë të kënaqshme, megjithatë mund të bëhen një a dy ndryshime. Gazeta "Politika" më 20 gusht është nxitur që të sulmojë këtë konkluzion të bërë nga një gazetë serbe në Prishtinë, ku theksoi se pikërisht autorët dhe botuesit e librave kishin qenë përgjegjës për kontrollin e tyre. Për shembull, në një libër historie, gabimet ishin të shumta dhe të dukshme: fotoja e Titos mungonte në faqen e përparme të librit; Tito thuhej se ka lindur "shumë larg nesh"; emri i plotë i Jugosllavisë ishte dhënë në mënyrë të pasaktë; është ngatërruar dallimi i rëndësishëm jugosllav midis termave "kombe" dhe "kombësi"; dhe është pasqyruar lufta partizane në Kosovë por jo lufta tjetërkund në Jugosllavi. Me fjalë të tjera, libri portretizonte një pamje tejet 'Kosovo-centrike' të botës.

5. Në ditët e ardhshme shtypi nxori më shumë shembuj të librave të papërshtatshëm, shpesh të shkruar prej shqiptarëve nga Shqipëria, në të cilat tonet nacionaliste ishin mjaft të qarta. Më 29 gusht Këshilli i Arsimit të Kosovës bëri të ditur se nuk ishte pranuar konkluzioni i mëparshëm dhe përmendi 14 libra të cilët do të hiqeshin nga përdorimi në gjuhën dhe letërsinë shqipe. Gjithashtu,

Komiteti Ekzekutiv i Kuvendit serb vendosi të hetonte përgjegjësinë e inspektorëve të shkollave, të cilët kishin aprovuar materiale të tilla si të përshtatshme.

6. Është interesante se autoritetet në Mal të Zi dhe Maqedoni gjithashtu nuk lanë gur pa lëvizur. Kështu, në Mal të Zi u zbulua se kurset e letërsisë që mësoheshin aty në gjuhën shqipe, i kushtonin rreth 67 orë letërsisë nga Shqipëria dhe vetëm 59 orë letërsisë jugosllave dhe asaj botërore. Në Maqedoni deri në 40% të teksteve shkollore aktuale në gjuhën shqipe vinin nga autorë të Shqipërisë e madje edhe nga shqiptarë që jetonin në Bullgari. Vetëm 7 (!) libra aktualisht në përdorim në orët e gjuhës shqipe në shkolla, ishin të përshtatshme për t'u përdorur në vijim. Në një mbledhje të Këshillit Arsimor Republikan në Shkup më 28 gusht, thuhej se "këta libra shkollorë ushtronin prej vitesh një influencë negative". Disa prej tyre madje glorifikonin Stalinin dhe Enver Hoxhën. Thirrje të forta ishin bërë që personat përgjegjës të viheshin para përgjegjësive. Megjithatë, deri tani asnjë person nuk është dënua rëndë për këtë çështje në Kosovë, ose në Maqedoni apo Mal të Zi. Me të vërtetë, kaq shumë mësues dhe zyrtarë janë përfshirë sa që do të ishte e vështirë për të ditur se ku të fillohej – apo ku të ndalohej. Duke komentuar këtë çështje në tërësi, një artikull i gazetës "Borba" më 1 shtator vinte në dukje me sarkazëm se Universiteti i Prishtinës kishte "1,022 mësues, duke përfshirë 244 me gradën Dr. dhe 216 me gradën Ma., por nga 143 libra shkollorë që përdorehin rregullisht në fakultetet e Universitetit, vetëm 38 prej tyre ishin shkruar në Jugosllavi".

7. Pak lajme ka pasur që prej letrësime të datës 28 korrik, në të cilën në paragrafin 4 kam përmendur se regjistrimi i studentëve në klasat ku mësimi jepej në gjuhën serbo-kroate, nuk ka shkuar aq mirë,

megjithatë janë pritur përmirësime. Sidoqoftë, 'raundi' i dytë i regjistrimit nuk ka dhënë shumë kënaqësi në këtë rezultat; më 26 gusht ishte njoftuar se ishin zënë të gjitha vendet në degët e fakultetit të drejtësisë, mjekësisë, ekonomikut dhe fakulteti bujqësor, por në lëndë të inxhinierisë, metalurgjisë, matematikës dhe në lëndë të tjera të tilla kishte shumë pak të regjistruar, veçanërisht kur mësimi jepej në gjuhën serbo-kroate. Ndërkohë, vazhdon 'raundi' i tretë i regjistrimit. Në të kundërt, e vetmja pikë tjetër për t'u theksuar doli në një artikull në gazetën "Politika" më 14 gusht, ku shqyrtoheshin hapat e marrë (të cilat janë përmendur në letrat tona) për të siguruar se komunitetet lokale ushtrorinë kontroll shumë më të rreptë mbi studentët nga krahinat e tyre. Është identifikuar edhe problemi i studentëve që pranojnë bursa nga firmat e më pas dështojnë të përmbushin detyrimet e tyre. Gjatë pesë vjetëve të fundit, kompleksi gjigant "Trepça" ka sponsorizuar 2,090 studentë të universitetit dhe shkollës së mesme në pritje që të punësonte për pasojë mbi 1,000 ekspertë të rinj. "Por vetëm 211 studentë kanë përmbushur detyrimet e tyre ndaj ... kolektiv ... një numër i madh janë zhdukur pa lënë gjurmë dhe 620 studentë kanë humbur bursat e tyre pas rezultateve të dobëta". Ky fakt përfaqëson një humbje të madhe financiare për "Trepçën".

8. Më tej do t'ju raportoj më vete mbi përgatitjet për vitin e ri shkollor në Universitet, i cili fillon më 1 tetor.

Komente

9. Në artikullin e datës 1 shtator, gazeta "Politika" deklaronte se "çdo gjë është gati për fillimin e vitit të ri shkollor" dhe, duke folur në Prizren më 27 gusht, Sinan Hisani, Zëvendës/Kryetar i Kuvendit Jugosllav, tha prerazi se "fillimi i vitit shkollor do të tregojë nëse e kemi fituar betejën". Muajt e ardhshëm do të jenë një test i rëndësishëm si

për autoritetet e Kosovës dhe ato Federale dhe do të ketë shumë rrezik. Por problemet mbi tekstet shkollore tregojnë se ndryshimet që kërkohen, janë të thella dhe do të duhen muaj ose, në disa pika, edhe vite që rezultatet të jenë të dukshme. Sidoqoftë, 'shtypi i Beogradit' po shikon me skepticizëm të gjitha këto zhvillime në Kosovë, një fakt ky që duhet të jetë burim i vazhdueshëm i dështimit aty.

I Juaji

C. G. Crawford

Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit
FCO

-93-

Konfidenciale

GRS 161

Shkresë

Nga A. E. Montgomery,
Departamenti Sovjetik dhe i
Evropës Lindore
6 shtator 1981
Për ndjekje për T. J. Clark, Beograd
14 shtator 1981

Telegrami juaj nr. 156: dokumenti i EC/EEWG për Shqipërinë

1. Ju falënderoj për komentet tuaja mbi draft dokumentin për EEWG për Shqipërinë.
2. Jemi dakord që dokumenti duhet të përfshijë një përshkrim të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave mbi Kosovën dhe për këtë arsye kemi përfshirë një fjalë të re hyrëse siç është propozuar. Sidoqoftë, mendojmë se nëse bëhen ndryshime të rësore në të gjithë tekstin, artikulli do t'i shmangej shumë qëllimit kryesor, d.m.th. për të zbuluar më shumë për politikën e brendshme shqiptare nga partnerët tanë të KE të cilët kanë poste aty. Megjithatë jugosllavët vazhdojnë të flasin pa pushim për lidhje të pretenduara midis nacionalistëve kosovarë dhe Tiranës, aluzione të ndërthurura për përfshirjen e sovjetikëve, pak prova janë ofruar për këto deklarata. Por keni të drejtë që pasoja e ndryshimit të regjimit për Jugosllavinë meriton një vlerësim më nga afër dhe po mendojmë mbi mundësinë që EEWG t'i drejtohet këtij aspekti të problemit në një datë të mëvonshme.

Nënshkruar nga A. E. Montgomery

-94-

Për përdorim të kufizuar

A. E. Montgomery Esq
Ambasada britanike
Departamenti Sovjetik dhe i
Evropës Lindore
Beograd
8 shtator 1981
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
I nderuar Alan,

Kosova: situata e sigurisë

1. Siç kam raportuar në letrën e 1



shtatorit, situata e sigurisë është përmirësuar. Kryesia e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës u mbledh më 5 shtator për të shqyrtuar situatën dhe, sipas "Tanjug", arriti në përfundimin se ishte më e mirë se më parë, por nuk kishte arsye për vetëkënaqësi. Viti shkollor kishte filluar normalisht dhe procesi i "diferencimit" po bëhej gjithnjë e më i suksesshëm.

2. Ky njoftim u shoqërua me një sërë raportesh në shtyp nga pjesë të ndryshme të Kosovës, ku komitetet lokale të LK-së po zhvillonin në shqyrtim të ngjashëm të situatës në komunat e tyre. Tabloja e shfaqur kishte tendencën të konfirmonte konkluzionin e Kryesisë përveç në komunën e Ferizaj, ku kishte probleme të hapura. Këtu, duket se situata e sigurisë ka mbetur "e ndërlikuar" dhe aktiviteti i nacionalistëve nuk tregon shenja pakësimi, veçanërisht në fshatrat përreth vetë Ferizajt. Ata vazhdojnë të shkruajnë parulla, të qarkullojnë pamflete, të dëmtojnë të korrat, si dhe të rrethojnë dhe të angazhohen në zjarrvënie. Ky aktivitet u intensifikua në gusht dhe bëri që serbët lokalë të kërkonin masa të ashpra kundër të gjithë shqiptarëve. Serbë të tjerë thjesht vendosën të shpërngulen nga krahina.

3. Komiteti Qendror serb dhe Kryesia serbe u mbledhën së bashku më 7 shtator dhe, midis të tjerash, shqyrtuan çështjen e Kosovës. Vlerësimi i tyre ishte më i kujdesshëm me efektin se të gjitha përpjekjet e bëra deri tani kishin kontribuar në normalizimin gradual të situatës politike dhe të sigurisë por që kishte mbetur e ndërlikuar dhe aktive. Ata miratuan më tej, masa të papërcaktuara qartë "për normalizimin e plotë të situatës në Kosovë".

4. Sot arritëm që të marrim një lejkalim për Atasheun e Mbrojtjes dhe djalin e tij që të kalonin në Kosovë nga dy rrugë të ndryshme me ndalime natën në Prishtinë dhe Pejë gjatë rrugës për në Ohër dhe prej andej përmes Tetovës. Pas kthimit të tij më 14 shtator, do t'ju informoj nëse përshtypjet e tij konfirmojnë përmirësimin e raportuar.

I Juaji
T. J. Crark
Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit
FCO
Zyra e Kancelarit
UKDEL NATO Bruksel

-95-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Beograd
8 shtator 1981
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
I nderuar Charles,

Kosova: probleme ekonomike

Përmbledhje

1. Në disa fronte, Kosova ka bërë progres të rëndësishëm gjatë dy dekadave të fundit, por janë bërë

gabime të rëndësishme në strategjinë e përgjithshme të zhvillimit. Dy dekadat e rritjes së shpejtë të popullsisë nënkuptojnë se tashmë nuk ka më mundësi për të cilat do të rriten me të shpejtë gjatë 5 vjetëve të ardhshme. Baza industriale e Krahinës ka nevojë të theksuara për shumica të mëdha kapitalesh, e cila, në përgjithësi, është joefikase dhe e cenueshme ndaj prishjes; Për më tepër, aktualisht raportohen humbje të panumërta. Gjithashtu, sistemi arsimor i Kosovës nuk është duke i siguruar ekonomisë lokale aftësitë e duhura, një problem i cili i shtohet emigrimit të serbëve dhe malazezëve të aftë. Janë planifikuar më shumë investime masive, por pjesa më e madhe e tyre është lënë rezervë për të paguar për përfundimin e (dhe për të subvencionuar humbjet) komplekseve industriale ekzistuese të Kosovës.

2. Çfarë duhet bërë? Meqenëse asgjë nuk mund ta pengojë zgjerimin e shpejtë afat-shkurt të tregut të punës, Kosova duhet ose të krijojë vende të reja pune ose të eksportoje punëtorë ose të aplikojë të dyja rastet. Nuk është e nevojshme që të zbatohen menjëherë reforma të papëlqyeshme në sistemin arsimor. Gjithashtu, duhet të rrenjosez disa në mendjen e të gjithëve një kuptim më i madh i disiplinës dhe përgjegjësisë në punë. Por, duke pasur parasysh krizën ekonomike të zhvillimit në Jugosllavi, e ardhmja afatshkurt duket e zyrtë. Atëherë, a mundet Jugosllavia që ekonomikisht të përballojë vazhdimin e mbështetjes për Kosovën? A mundet që ajo politikisht të mos ta bëjë një gjë të tillë?

Detaje
3. Trazirat nacionaliste në Kosovë në mars dhe prill çuan në rivlerësime të gjera publike të pozitës kushtetuese të krahinës brenda Jugosllavisë dhe të të gjitha aspekteve të performancës politike të Kosovës. Megjithatë, gjatë verës, shtypi ka tërhequr vëmendjen në mënyrë të kujdesshme në rritjen e vështirësive ekonomike që kjo krahinë po pësonte. Raportimi ynë në këtë drejtim mbi Kosovën ka qenë deri tani i kufizuar në një vlerësim të përbashkët të ambasadave të KE në Beograd, të cilat trajtuan në përgjithësi disa (por jo të gjitha) nga çështjet kryesore. Ambasada e Shteteve të Bashkuara bëri më 23 korrik një analizë më të plotë të problemeve ekonomike të Kosovës (dërgohet një kopje bashkangjitur). Analiza në vijim është planifikuar për të plotësuar këto dy studime dhe bazohet në një shqyrtim të artikujve të shtypit që në muajin prill (është shfrytëzuar përshkrimi i gazetës "Politika" përveç rasteve kur shprehet ndryshe). Por të dhënat e cituara në shtyp, kanë qenë në mënyrë karakteristike të paqarta ose të paplota ose vetë-kontradiktore. Për rrjedhojë, ndërkohë që vlerësimi i përgjithshëm duket i vlefshëm, kërkoj falje për prezantimin domosdoshmërisht të parregullt (dhe 'jo shkencor!') të fakteve



mbështetëse.

Disa komente të përgjithshme

4. Përpara vazhdimin të analizimit të temave kryesore, vlen të përmendet se me gjithë shenjat e dukshme të ndryshimit shoqëror, veçanërisht në Prishtinë, në disa zona rurale të Kosovës, njerëzit jetojnë ende sipas mënyrave tradicionale dhe normave sociale, të cilat janë zhdukur disa dekada më parë tjetërkund në Evropë. Për shembull, artikujt e fundit të revistave raportojnë vazhdimin e gjakmarrjes së përhapur, ndërkohë që "gratë në shumë fshatra nuk lejohen të shikojnë TV që ndodhen në vendet e burrave". Komunikimet kanë mbetur të dobëta në Krahinë megjithëse këtë javë është njoftuar një nismë e re për të elektrifikuar të gjitha fshatrat e Kosovës. Lidhjet tradicionale të sistemit karakteristik kosovar "Zadruga" (familjet e mëdha) janë ende të fuqishme dhe pjesa më e madhe e fuqisë punëtore industriale është 'brezi i parë', pra të pamësuar me disiplinën që kërkojnë teknikat moderne të prodhimit.

5. Prej këndeje, del që ashtu siç ekziston aspekti "veri-jug" në zhvillimin e Kosovës që është përmbledhur mirë në dokumentin e Shteteve të Bashkuara (pp 2-3), po kështu mund të thuhet se modeli i vetë-zhvillimit në Kosovë ka krijuar një model klasik 'qendër-periferi' aty. Prishtina, me Universitetin e saj të mbushur me studentë, biblioteka e saj e re e mrekullueshme, hoteli i saj pesë-yjesh si dhe ndërtimi i gjallë i ndërtesave publike dhe private dominon në provincë si nga ana politike dhe sociale. Investimet e mëdha publike aty kanë nxitur shpërnguljen e thekuar rurale-urbane, shumë më larg se kapaciteti i qytetit për të siguruar punë ose akomodim, duke arritur rezultatet e dyfishta të prishjes së modelit të jetës tradicionale në të gjithë Krahinën për asnjë qëllim praktik, dhe të krijimit të një 'proletariati të painteresuar' urban, perspektivat e të cilit janë të varfra, por aspiratat e të cilit janë padyshim të ushqyera nga stili i mirë i jetesës i elitës së privilegjuar (të punësuar). Askush nuk është e nevojshme të pajtohet me determinizmin e ashpër Marksist për të pranuar se në këtë pjesë të Ballkanit po shpaloset modeli aktual i njohur i modernizimit të

shpejtë, por të keqdrejtuar që më shumë shkakton probleme sociale sesa i zgjidh ato kur përplasen me mentalitetet dhe stilet tradicionale të jetesës.

Punësimi

6. Një grup i thjeshtë shifrash shpjegon problemin e papunësisë në Kosovë:

Popullsia e përgjithshme e Kosovës 1981: 1,600,000
Numri i përgjithshëm i të punësuarve 1981: 200,000
Numri i përgjithshëm i të regjistruarve si të papunë 1981: 72,000

Numri i llogaritur i të sapoardhurve në tregun e punës 1981 - 1986: 190,000

Numri i përgjithshëm i planifikuar për vende të reja pune 1981 - 1986: 75,000

Numri i përgjithshëm i parashikuar i të papunëve 1986: 200,000

Me fjalë të tjera, rritja e shpejtë e popullsisë e viteve 1960, po fillon t'i hedhë të larguarit nga shkolla në tregun e punës shumë më shpejt nga sa mund të qëlltë ekonomia lokale. Ka më shumë të ngjarë që, së paku, gjysma e popullsisë së moshës për punë të mbetet pa punë në 5 vitet e ardhshme - dhe do të ishte e çuditshme nëse Kosova do të siguronte një numër të mjaftueshëm të punëve të reja në mënyrë që të mos lejonte rritjen e këtij proporcioni.

7. Një ndarje e detajuar e shifrave të censusit të vitit 1981, nuk është ende e disponueshme. Kur kjo të bëhet, do të jemi në gjendje të krijojmë një përshkrim më të saktë të këtyre faktorëve demografikë. Por, duhet të konfirmohet forca shtytëse e analizës së mësipërme.

8. Gazeta "Politika" komentoi më 16 gusht me pesimizëm probleme të tjera të punësimit në Kosovë. Kapacitetet ishin veçanërisht të pashfrytëzuara; Rrallë ka filluar puna me turne, por është përdorur gjerësisht puna me kohë të zgjatur. Më shumë femra aktualisht kërkojnë punë. 64 % e njerëzve të regjistruar që kërkojnë punë kanë mbërritur rishtazi nga fshatrat. Rregulloret për punësimin e fillestarëve injoroheshin. Sektori i bujqësisë dhe biznesit të vogël ishin neglizhuar. 7000 'mjeshtrit' e Krahinës punësuan vetëm 9000

njerëz dhe zgjerimi i planifikuar në sektorin e vetë-punësimit të 7500 punëtorëve gjatë 5 viteve të ardhshme ishte mjaft i papërshtatshëm. Zgjerimi i punësimit në sektorin bujqësor as që figuronte në planet zyrtare. Trajnimi për mjeshtri të ndryshme për të papunët ishte po aq i nevojshëm sa edhe drejtimi i investimeve në drejtim të fabrikave të përpunimit që kërkonin shumë fuqi punëtore fati i të cilave nuk ishte i lidhur kaq ngushtë me atë të industrive përtej Kosovës. Nevojiteshin përmirësime të sistemit për të informuar kosovarët për vende pune tjetërkund në Jugosllavi me qëllim që të zhvillohej një lëvizshmëri më e madhe e fuqisë punëtore.

9. Sidoqoftë, 'ekonomia joformale' po ndihmon në mbushjen e disa hapësirave të mëdha që tregojnë shifrat zyrtare (dokument i SHBA, p.4), si në Kosovë dhe më gjerë. Shqiptarët njihet se janë punëtorë të zellshëm në Jugosllavi dhe ndoshta një numër i madh i tyre enden nëpër vend duke kryer punë fizike në të zeze në biznesin fitimprurës të ndërtimit dhe rregullimit të shtëpive dhe duke dërguar para në shtëpi. Megjithatë, kjo lloj ekzistence zor se mund të funksionojë, mijëra studentë të diplomuar nga Universiteti i Prishtinës, të cilët do të vërshojnë në tregun e punës gjatë viteve të ardhshme. Planet aktuale duket se ofrojnë siguri të pamjaftueshme për këtë grup.

Investimet
10. Siç sugjerohet në paragrafët e mësipërm, politika e investimeve në Kosovë ka krijuar një strukturë të pandryshueshme industriale. Prej rreth 200.000 personave të punësuar zyrtarisht 26% janë angazhuar në "aktivitete jo-ekonomike" si organizata qeveritare, kulturore dhe sociale (dokument i SHBA, p.3). Kështu, rreth 150.000 veta punojnë vetëm në sektorin industrial, por disa komplekse gjigante përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të këtij totali; për shembull, kompleksi i minierës së "Trepçës" punëson 19.000 njerëz në 5 fabrikat e tij në Kosovë, ose çdo punonjës i tetë industrial në Krahinë.

11. Një gjë e tillë nuk është e rastësishme. Kur autoritetet qendrore nga mesi i viteve '60 nisën politikën e industrializimit të

shpejtë në Kosovë, ata e perceptuan me korrektësi se një aspekt i rëndësishëm i avantazhit të krahasuar të Kosovës qëndronte në shfrytëzimin e burimeve të saj të pasura me minerale. Por, industria e lehtë dhe bujqësia janë neglizhuar në favor të një ekonomie konglomerate që kërkon shumë kapital dhe ku neglizhenca ndjehet ende sot. Grupet e 'Trepçës', 'Kosovës', 'Feronikl' dhe 'Melioraca' kanë përvetësuar prej vitesh deri në 70% të kapitalit total të investimeve të planifikuar për zhvillimin e Krahinës. Këto grupe gjigante nuk janë mbërthyer vetëm nga paefektshmëria. Ato nevojitet të kenë gjithashtu investime të mëdha: centrali elektrik 'Kosova B' kërkon 4.3 miliardë dinarë, 'Feronikl' kërkon 3.9 miliardë dinarë dhe 'Ibër-Lepenci' kërkon 6.5 miliardë dinarë. Fatkeqësisht, Jugosllavia nuk ka zgjidhje tjetër veçse të vazhdojë me këto subvencionime të shtrenjta, të cilat përfaqësojnë 50% të shumës së investimeve të planifikuara për periudhën 1981-1985. Duke angazhuar veten me këtë strategji shumë të rëndë, autoritetet duhet t'i shohin si të papërfytyrueshme pasojat politike dhe sociale për tërheqjen e mbështetjes më të gjerë financiare në favor të një rruge të drejtë një strukture të larmishme industriale që kërkon shumë fuqi punëtore.

12. Dokumenti i SHBA-së (p.6-8) vë në dukje fitimet e ulëta në kapitalin e investuar që Kosova ka përfaqësuar deri më sot. Thuhet se ky fitim kushton dy herë më shumë për të hapur një vend të ri pune në Kosovë dhe tjetërkund në Jugosllavi. Duke shtuar vërejtjet e përgjithshme se produktiviteti është shumë i ulët, se kapacitetet janë tejet të pashfrytëzueshme, se projektet kanë përfunduar shpesh me vonesë dhe se objektivat e prodhimit po humbasin me një diferencë të madhe, njeriu arrin në konkluzionin se tabloja është mjaft e zymtë. Autoritetet kanë filluar tashmë të përfshijnë realitetin ekonomik në këtë situatë, duke reduktuar elementet neto të grandeve në fondet e përgjithshme të investimeve për Kosovën dhe duke inkurajuar ndërmarrjet e përbashkëta që kërkojnë shumë fuqi punëtore me firma nga Republikat e tjera (Plani 5-vjeçar i rishikuar për vitet 1981-1985 pritet që të sjellë sigurimin e plotë të këtyre lëvizjeve kur të dalë më vonë këtë muaj).

Humbjet dhe disiplina industriale 13. Në të vërtetë, këto firma do të duhet të kenë një shpirt të guximshëm sipërmarrjeje nëse nuk do të pengohen nga raportimet e fundit të shtypit mbi paefektshmërinë e tmerrshme, humbjet gjigante dhe rritjet e tepërta të pagave në ndërmarrjet kosovare. Në Kuvendin e Kosovës, më 14 korrik është raportuar se megjithëse prodhimi industrial po përmirësohej në disa zona, situata ekonomike ishte ende "shumë e komplikuar". Kështu, gjatë 5 muajve të parë të këtij viti, prodhimi i qymyrit ka rënë (me 297.000 tonë), po ashtu si prodhimi i energjisë elektrike (me 237



milione për kilovat/orë). Çmimet e qymyrit janë rritur me 75%, por efektet ishin "zbutur" në uljen e prodhimit dhe rritjen e pagave. Më 8 shtator, humbjet e llogaritura në të gjithë Kosovën për gjashtë muajt e parë të vitit 1981, u deklaruan se ishin 1.57 miliardë dinarë, 136% më shumë sesa në periudhën korresponduese të vitit 1980. Pagat personale në disa firma që prodhonin humbje apo që ishin në prag të falimentimit, kishin kapërcyer në 50% ndërkohë që faturat e firmave ishin rritur shumë pak.

14. Një raport i botimit të gushtit të revistës "Duga" mbi bazën e kontakteve me disa ndërmarrje të mëdha në Kosovë, bëri të njëjtin përshkrim: Prodhim më i ulët sesa planifikimi, vetëkënaqësi në radhët e fuqisë punëtore, humbje të mëdha dhe rritje të mëdha të pagave. Një zyrtar në "Trepçë" citoi: "Çështja është se si të stimulohet rezultati i prodhimit thelbësor...shkaku kryesor është mungesa e interesit të punëtorëve në prodhim". Në Trepçë, paga mesatare nga janari në qershor ishte aktualisht 130% më e lartë sesa paga në periudhën korresponduese të vitit 1980, por pa rezultat. Minatorët vinin vonë në puse; përgjegjësit ishin të pakualifikuar; shmangia/mosvajtja ishte e përhapur; gjithashtu ishin raportuar raste sabotimi.

15. Kjo mungesë e dukshme endemike e disiplinës në fabrika duhet të jetë një burim i madh shqetësimi për autoritetet qendrore. A është ky një shqetësim relativisht jetëshkurtër i fuqisë punëtore me një këndvështrim tejet rural të gjërave që kombinohen me nevojat për prodhimin në masë? Apo në vend të kësaj a është kjo një llogaritje cinike e bërë nga ana e punëtorëve që në të vërtetë nuk ka rëndësi se çfarë niveli tolerimi ata zgjedhin ndërkohë që Serbia (dhe Jugosllavia) nuk rezikojnë që t'i lejojnë këto komplekse kaq të rëndësishme të shkojnë dëm?

Përgjigja zyrtare

16. Më 13 korrik u organizua mbledhja e përbashkët e Kryesisë së Kosovës dhe Kryesisë së LK të Kosovës. Situata ekonomike u vlerësua "se ishte për pjesën më të madhe e pakënaqshme ... ku, në veçanti, mbizotëronin kushtet e vështira dhe të ndërlikuara në

periudhën pas demonstratave armiqësore". U arrit në konkluzionin se detyrë parësore ishte aktiviteti intensiv dhe i mirë organizuar "për të zgjidhur problemet e fondeve të investimit në Krahinë; për të plotësuar projektet e nisura dhe për t'i vënë ato në funksion; për të shënuar mjetet për përfundimin e investimeve aktuale (veçanërisht ato që përfshijnë punën tjetërkund në Jugosllavi); për të zgjidhur problemet e vënies së çmimeve në mbrojtje të standardeve të jetesës dhe furnizimeve me ushqime dhe mallra bazike; për të rritur shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese dhe rritjen e punës prodhuese"; e kështu me radhë. Nuk ka një listë të detajuar të sugjerimeve.

17. Megjithatë, pas këtyre këshillave të mërziutshme, janë zhvilluar diskutime gjatë verës midis Kosovës dhe Republikave të tjera për investime në këtë Krahinë. Më 21 korrik, gazeta "Borba" raportoi bisedimet e bëra për bashkëpunimin ekonomik midis ndërmarrjeve në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë. U arrit marrëveshja për të ndërtuar dy fabrika të reja për skelete biçikletash dhe biçikleta, duke krijuar kështu me qindra vende pune. Puna do të fillonte "pas gjashtë muajsh". Më 19 gusht, përfaqësuesit serbë dhe kosovarë diskutuan mundësitë për hapjen e nëntë fabrikave të reja, duke përfshirë një të tillë në Deçan që kushtonte 320 miliardë dinarë. Gjithashtu, më 28 gusht, u njoftua për një larmi projektesh të reja që përfshinin firmat kroate në lidhje me produkte të tilla si pajisje frigoriferike, turbina, kompresorë, fabrika të përpunimit të gurit, ëmbëlsira dhe biskota, si dhe qumësht. Gjithsej, deri tani janë planifikuar në vlerën 4 miliardë dinarë investime më pak madhështore në ndërmarrje të përbashkëta, duke treguar se së paku po bëhen përpjekje për të marrë disa hapa pozitive.

18. Dokumenti i SHBA jep gjithashtu një përmbledhje të mbështetur të përgjithshme të mangësive në sistemin arsimor në Kosovë (p.4 dhe 5), megjithëse do të përmendja se shifra e cituar prej 47,000 si madhësi e trupës studentore në Universitetin e Prishtinës është zëvendësuar nga shifra zyrtare prej 28,608 (shkresat

e mia dërguar për ju më 10 qershor dhe 28 korrik janë ndalur në problemet e rënda politike në Universitet dhe hapat e marrë deri tani për zgjidhjen e tyre). Së fundi, dokumenti i SHBA vlerëson me kujdes humbjet e shkaktuara në ekonominë e Kosovës drejtpërdrejt nga vetë trazirat, për të cilat mund të shtoj se nuk ka të ngjarë që të mësojmë ndonjëherë shtrirjen reale të dëmeve ekonomike të shkaktuara nga trazirat nacionaliste të pranverës, nga emigracioni i serbëve dhe malazezëve të kualifikuar, por edhe nga veprimet e errëta të përçarjes dhe sabotimit të cilat nuk janë pasqyruar në media.

Komente

19. Disa ekspertë jugosllavë pëlqejnë të shprehen se nuk ekziston asnjë dallim real ndërmjet problemeve ekonomike me të cilat përballet Kosova dhe atyre me të cilat përballet Jugosllavia në tërësi; është thjesht fakti se në Kosovë problemet janë shumë më të vështira dhe delikate. Diskutimi i mësipërm në njëfarë mënyre e mbështet këtë ide. Historia e investimeve të keq-menaxhuara, rritjes së papunësisë, paaftësisë në punë dhe neglizhencës së bujqësisë gjen zbatim në të vërtetë në të gjithë Jugosllavinë dhe nuk është vetëm një anomali lokale. Megjithatë, norma e shpejtë me të cilën edhe në rastin më të mirë do të rritet papunësia në Kosovë gjatë viteve të ardhshme dhe dobësia drastike e strukturës industriale të lartë joefikase atje, shkakton shqetësim të veçantë në Jugosllavi dhe jashtë kufijve të saj. Shpërthimet nacionaliste këtë pranverë padyshim kanë nxitur kërkimin për të rishqyrtuar një strategji afatgjatë zhvillimi në këtë Krahinë dhe padyshim që do të bëhen ndryshime. Sidoqoftë, çështja është nëse janë ndjekur me vendosmëri politika të gabuara në Kosovë për një periudhë tepër të gjatë. A munden autoritetet të ndryshojnë drejtim?

20. Përgjigja do të kërkojë kohë. Në këtë fazë, njeriu mund të thotë vetëm se autoritetet qendrore dhe serbe kanë njohur së paku dimensionet e problemit dhe duket se po bëjnë përpjekje më të mëdha me udhëheqjen e re në Kosovë për trajtimin e këtij problemi. Plani 5-vjeçar i rishqyrtuar do të japë disa tregues të qëllimeve të tyre, por aftësia për

t'i zbatuar ato, do të varet nga një shumëllojshmëri faktorësh, duke përfshirë zgjidhjen politike (së paku afatshkurtër) të problemit nacionalist dhe progresin e Jugosllavisë për të arritur stabilizimin ekonomik. Kjo çon në një detyrë të vështirë edhe në rrethana të favorshme dhe aktualisht duket se nuk ka shanse për sukses. Por nuk ka alternativë të pranueshme për përpjekjen e bërë, nëse nuk do të ndodhin shpërthime të tjera nacionaliste dhe nëse nuk do të kërcënohet integriteti territorial i Jugosllavisë.

I Juaji

C. G. Crawford

-96-

Konfidenciale

(014/427/1)

Ambasada britanike

A. E. Montgomery Esq

Beograd

14 shtator 1981

Departamenti Sovjetik dhe i

Evropës Lindore

Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit

I nderuar Alan,

Artikull i EC/EEWG për Shqipërinë

1. Ju falënderoj për shkresën tuaj të datës 8 shtator mbi artikullin që do të shqyrtohet në Grupin e Punës së Evropës Lindore për Shqipërinë pas epokës së Hoxhës. Jam dakord me mendimet tuaja.

2. Ndërkohë, kam takuar së fundmi Denny Rusinow, i cili raporton nga Vjena për Stafin e Fushës së Universiteteve Amerikane dhe i cili është ekspert i njohur për Jugosllavinë. Ai më dha një kopje të dy artikujve që ka shkruar për Kosovën në fund të vitit 1979, të cilat, në retrospektivë, janë të jashtëzakonshme për parashikimin e tyre. Ato lidhen veçanërisht me konsideratat e juaja aktuale në faktin që ai shprehu në atë kohë të njëjtën çështje për aspiratat e nacionalistëve shqiptarë të Kosovës për Shqipërinë e Madhe pas Hoxhës. Bashkangjitur po ju dërgoj një fotokopje të ekstraktit përkatës.

I Juaji

T. J. Crank

-97-

D G Manning Esq

Ambasada britanike

EESD

Moskë

17 shtator 1981

FCO

I nderuar David,

Kosova

1. Në një artikull të rrallë për Kosovën, gazeta "Pravda" e datës 12 shtator raportoi se Kryesia e LKJ ka diskutuar një program tjetër masash për të normalizuar situatën e brendshme politike në Kosovë. "Pravda" komentoi se situata e shkaktuar nga trazirat dhe demonstratat e rrugëve në pranverë ka mbetur e ndërlikuar. Shtypi jugosllav i ka përshkruar këto ngjarje si "armiqësore dhe kundërrevolucionare" dhe që synonin prishjen e unitetit të popullit jugosllav.

2. Vazhdonin përpjekjet për manifestime të reja provokuese, e



po kështu vazhdonte përhapja e materialeve armiqësore, formave të ndryshme të terrorit dhe dhunës. Organizatorët dhe aktet subversive ishin grupuar së bashku në të njëjtën platformë të nacionalizmit shqiptar. Sipas raporteve të shtypit, 189 persona janë dënuar për akte kundërrevolucionare dhe nacionaliste. Gazeta "Borba" është shprehur se nga LKJ dhe organizata të tjera socio-politike nevojitet një punë aktive politike dhe edukuese për të normalizuar plotësisht situatën. Kryesia ka theksuar se një prej detyrave bazë do të mbetet lufta pa kompromis kundër aktivitetit subversiv.

E Juaja
Anne Jackson
Për dijeni:
Departamenti i Kërkimit, FCO
Zyra e Kancelarit, BEOGRAD

-98- Konfidenciale

A. E. Montgomery Esq
Ambasada britanike
Beograd
17 shtator 1981
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
I nderuar Alan,

Kosova: situata e sigurisë

1. Kam raportuar në letrën time të datës 8 shtator se i kisha kërkuar Atasheut të Mbrojtjes që të përdorte lejen e dhënë kohët e fundit për diplomatët që të vizitojnë Kosovën - si turistë. Kolonel Eaton bëri një turne midis datave 10 dhe 14 shtator dhe hartoi një raport të detajuar për DIS, MOD. Për coincidençë, kolegu i tij amerikan vizitoi Kosovën në të njëjtën kohë, megjithëse vetëm për pak orë, dhe na dha një kopje të raportit të tij. Unë jam bazuar tek të dy raportet për të dhënë një përshkrim të situatës aktuale të sigurisë në Kosovë dhe pjesë të Maqedonisë.

2. Koloneli Eaton mori rrugën në shumicën e qendrave më të rëndësishme të demonstratave të mëparshme nacionaliste shqiptare në Kosovë dhe Maqedoninë Perëndimore dhe kaloi natën në Prishtinë, Ohër dhe

Pejë. Përfaqësuesi i SHBA kaloi vetëm një pjesë të Kosovës përmes Prishtinës dhe Nishit. Gjithsesi, konkluzionet e tyre ishin pak a shumë të njëjta se autoritetet duket se kanë situatën nën kontroll, megjithëse në dëm të vendosjes së një numri të madh forcash të sigurisë aty. Nga përshkrimet e tyre duket se në qytetet kryesore jeta në përgjithësi i është kthyer normalitetit dhe atmosfera është qetësuar me gjithë patrullat e armatosura rëndë të milicisë të përhapura kudo. Forcat e Armatosura (JNA) duket se nuk kanë pasur ndonjë rol të dukshëm në ruajtjen e sigurisë. Përveç disa parullave, të cilat nuk ishin domosdoshmërisht nacionaliste, Kolonel Eaton nuk pa prova të trazirave për të cilat autoritetet thonë se vazhdojnë, d.m.th. shkarravitja e parullave politike, shpërndarja e pamfleteve dhe akteve të intimidimit. Madje edhe Tetova dhe Ferizaj, të cilat janë përmendur kohët e fundit si vende të trazirave të vazhdueshme, duken të qeta. Hyrja dhe dalja nga Kosova në rrugët kryesore ende kontrollohet dhe po kështu lejkalimet diplomatike kërkojnë, por përfaqësuesi i SHBA zbuloi se në një rrugë dytësore për në Nish nuk kishte fare kontroll.

3. Shpresojmë që të rregullojmë një vizitë nga një anëtar i Zyrës së Kancelarit në të ardhmen e afërt dhe të raportojmë në kohën e duhur.

I Juaji
T. J. Crank
Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit

-99-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
29 shtator 1981
EESD
FCO
I nderuar Charles,

Kosova: përgjegjësia e Mahmut Bakallit

Përmbledhje

1. Raporti i komisionit të ngritur për të shqyrtuar përgjegjësinë politike të Mahmut Bakallit (pjesë

të të cilit ishin zbuluar në gusht) është botuar tashmë i plotë. Bëhet fjalë për një përshkrim të detajuar dhe dënues për rritjen e nacionalizmit shqiptar në Kosovë dhe dështimin e Bakallit për ta trajtuar atë apo për të informuar autoritetet serbe ose ato shtetërore në këtë drejtim. Raporti hedh poshtë çdo sugjerim se autoritetet e Kosovës ishin zënë në befasi në mars dhe në prill nga shtrirja e nacionalizmit shqiptar në Krahinë. Publikimi i këtij raporti mund të paralajmërojë fillimin e procedurave kundër vetë Bakallit.

Detaje

Komisioni dhe gjetjet e tij

2. Pas demonstratave nacionaliste në Kosovë në mars dhe prill, Kryetari i LKK, Mahmut Bakalli, dha dorëheqjen më 5 maj (Telegram nr. 56 datë 6 maj, Beograd); Ai më pas u largua nga Kryesia e LKK në korrik (letra e Terence Clark drejtuar Alan Montgomery më 21 korrik). Tashmë, e dimë se Kryesia e KQ të LKJ vendosi më 2 qershor 1981 që të ngrinte një Komision Special për të hetuar përgjegjësinë personale të Bakallit për dobësitë në politikën e LKJ të cilat kishin çuar në "përshkallëzimin e nacionalizmit të Shqipërisë së Madhe dhe irredentizmit".

3. Komisioni prej 6 vetash kishte në përbërje tre anëtarë të Komitetit Qendror të LK të Serbisë dhe tre anëtarë të Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, ekuivalenti krahinor. Pas diskutimesh të gjata me Bakallin dhe shqyrtimit të provave dokumentare në fillim të korrikut, Komisioni arriti konkluzionet e tij më 12 Korrik (letra e Terence Clark për Alan Montgomery e datës 10 gusht, paragrafët 13 dhe 14, përmendte se si gazeta "Politika" kishte nxjerrë disa nga gjetjet e Komisionit). Sidoqoftë, teksti i plotë ka dalë tashmë për herë të parë në gazetën "Komunist" të datës 25 shtator, dhe është ribotuar në gazeta të tjera. Është një dokument i rëndësishëm dhe i shquar, i cili ka vlerë të raportohet në disa detaje me rëndësi për shkak se konfirmon zyrtarisht shumë pika të ngjarjeve, të cilat shtypi i ka publikuar që në muajin prill.

Pamfletet e "Partisë Marksiste-

Leniniste të shqiptarëve në Jugosllavi"

4. Ndërkohë që Komisioni kishte detyrë në përgjithësi të hidhte dritë mbi përgjegjësinë e Bakallit për mangësitë e LKJ, ai i kushtoi vëmendje të veçantë së pari faktit që LKJ dhe LKS nuk ishin njoftuar për pamfletet armiqësore të dërguara në mënyrë anonime tek Bakalli dhe udhëheqësit e tjerë të Kosovës. Pamfletet u dërguan prej marsit 1979 deri në janar 1981, dhe pretendohet se vinin nga "Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi" (ose PKMLSHJ). Një pamflet i tillë mesa duket shkonte deri në 140 faqe dhe rendiste strukturën dhe statusin e PKMLSHJ. Autoritetet e sigurisë së Kosovës i mblodhën këto dokumente por autoritetet qendrore të LKJ i panë ato vetëm më 24 prill 1981. Në fakt, shumica e anëtarëve të Kryesisë së Komitetit Krahinor gjithashtu nuk patën dijeni deri atëherë për ekzistencën e tyre. Bakalli i shpjegoi Komisionit se megjithëse nuk kishte urdhëruar që pamfletet të dërgoheshin në Beograd, ai nuk kishte urdhëruar që ato të mos dërgoheshin; Një hetim u nis në këtë drejtim për zbulimin e autorëve. Komisioni konstatoi se ky hetim nuk zbuloi gjë, pjesërisht për arsye se mungonte një analizë serioze e detajuar politike e PKMLSHJ.

Si u mbajtën të fshehura incidentet nacionaliste

5. Raporti i Komisionit më pas përshkroi sesi dy mbledhjet e Komitetit Krahinor të LKK në qershor dhe shtator 1979, kishin diskutuar një sërë incidentesh nacionaliste të kohëve të fundit në Kosovë (për shembull heqja e fotos së Titos dhe parullat, bojkotimi i mësimet, shpërndarja e fletushkave apo pritjet euforike që iu bënë orkestrave vizitore nga Shqipëria). "Kryesia e Komitetit Krahinor në këto mbledhje, veçanërisht gjatë mbledhjes së mbajtur në prag të vizitës së Titos në Kosovë ishte fare pranë vlerësimit të vërtetë të situatës politike në Krahinë". Edhe Bakalli kishte thënë se ngjarjet "po lëviznin në një drejtim të rrezikshëm që mund të krijonte një situatë të rrezikshme kritike" (!). Por, Komiteti Krahinor nuk kishte raportuar asnjë fjalë të këtyre problemeve pranë autoriteteve qendrore. Vetë Bakalli kishte shprehur shqetësimin se mos lajmet për të do të bëheshin publike dhe incidentet mund të ekzagjeroheshin dhe "dramatizoheshin". Komisioni konstatoi se ky qëndrim ishte shprehje "e liberalizmit" duke shtuar me forcë se Kryesia e Komitetit Krahinor nuk duhej të ishte habitur nga veprimet e armikut. Nuk ishte zhvilluar një betejë e hapur dhe publike kundër nacionalizmit.

6. Kur në vitin 1980 u arrestuan 55 nacionalistë, "mbi bazën e konsultimeve në Jugosllavi, Serbi dhe Kosovë" u vendos që të çoheshin në gjyq vetëm 19 krerët e tyre. Sidoqoftë, në vend që të mbanin qëndrim të vendosur (megjithëse ekstraligjor) kundër

personave të liruar, në të vërtetë autoritetet e Kosovës kishin shpërblyer sjelljen e tyre, duke i pranuar disa prej tyre sërish në shkolla dhe duke u dhënë bursa. Ku ishte në një politikë të tillë beteja kundër nacionalizmit? Përsëri, Bakalli i kishte thënë Komisionit si një shembull pozitiv të kontrollit nga ana e tij të situatës se ai ishte konsultuar për një kërkesë të disa shqiptarëve vizitorë që të hiqej fotoja e Titos. Por, siç tha Komisioni, vetë fakti që kjo çështje duhej madje të analizohej, tregonte sesa e çorientuar ishte bërë politika e LKK. Bakalli kishte refuzuar vazhdimisht për të lejuar publikimin e sulmeve nacionaliste, "nga frika se mos një gjë e tillë pengonte hetimet"; Në trajtimin e nacionalizmit shqiptar, ai e kishte parë publicitetin më tepër si një faktor përkeqësues sesa ndihmues. Ky qëndrim i kishte dekurajuar të gjithë ata që ishin të gatshëm për të vepruar me vendosmëri.

Emigracioni i serbëve dhe malazezëve

7. Autoritetet kryesore të Kosovës kishin dijeni gjithashtu për rastet e presioneve ndaj serbëve dhe malazezëve që të largoheshin nga Krahina, por Bakalli i kishte dënuar këto si gënjeshtër që synonin diskreditimin e udhëheqjes së Kosovës. Kishte pasur edhe raste të dëbimit të njerëzve nga LKK për faktin se kishin folur hapur për këtë çështje. Por, problemet e marrëdhënive në komunitet nuk ishin shfaqur në agjendën e Komitetit Krahinor që në Kongresin e 11-të të LKJ.

Nacionalizmi në medien e Kosovës dhe Universitetin e Prishtinës

8. Komisioni tha se në retrospektivë, Bakalli tashmë e pa se dobësia kryesore e LKK kishte qenë në mungesën e betejës së hapur dhe publike kundër nacionalizmit. "Ndërkohë që vlerësimet kritike të nacionalizmit shqiptar kishin mbetur brenda një qarku të mbyllur, pikëpamjet nacionaliste po shpreheshin publikisht dhe gjithnjë e më gjerësisht". Komisioni dha shembuj të ndryshëm pak a shumë të hapur të manifestimeve nacionaliste që ishin shfaqur në medien e Kosovës, duke shtuar se ishte lejuar gjithashtu që të zbuloheshin bashkëpunimi kulturor midis Universitetit të Prishtinës dhe atij të Tiranës. Bakalli kishte qenë në kontakt me autoritetet drejtuese të Universitetit në Prishtinë, por nuk kishte arritur të shihte se ku po çonte "romantizmi kombëtar" me të cilin u pajtuar disa prej tyre.

Demonstratat e 11 marsit

9. Megjithëse kishte pasur një përfshirje të qartë nacionaliste në demonstratat e 11 marsit, në të cilat u plagosën 20 milicë, një prej të cilëve me armë zjarri, Bakalli e kishte theksuar kërkesat "sociale" (d.m.th. për kushte më të mira) të studentëve. Udhëheqja kryesore e Kosovës në diskutimet e saj të nesërmen kishte folur kryesisht lidhur me faktin se çfarë do të

njoftohej publikisht dhe jo për vetë demonstratat. Në mbledhjen e radhës të Komitetit Krahinor, demonstratat ishin vënë në seksionin “ndonjëçështje tjetër” të agjendës. Shpjegimi i Bakallit ishte se mbledhja ishte thirrur tashmë dhe agjenda ishte përcaktuar - “një justifikim teknik por jo politik”.

Konkluzionet e Komisionit 10. Komisioni nuk kishte qenë në gjendje të mblidhte të gjitha rastet e nacionalizmit shqiptar në Kosovë gjatë viteve të fundit. Sidoqoftë, ishte e qartë se aktiviteti armiqësor vazhdonte prej një kohe të gjatë por që nuk ishte përballuar siç duhet. Përgjegjësia e udhëheqjes së Kosovës dhe e Bakallit personalisht ishte e padiskutueshme. Bakalli kishte argumentuar se udhëheqja kishte punuar në mënyrë kolektive. Megjithatë, Komisioni ishte i bindur se influenca e Bakallit dhe e zyrtarëve të tjerë të lartë ishte vendimtare. “Përgjegjësia personale nuk mund të zbutet duke u përfshirë në disa përgjegjësi kolektive, formale dhe të pacaktuara... Bakalli është përpjekur të gjejë justifikime për shumë gjëra që janë të pafalshme”. Qëndrimi i tij ndaj incidenteve nacionaliste ka qenë “liberal dhe i lëkundshëm”. Për pasojë, ai duhej të përjashtohej nga Komiteti Krahinor. Megjithëse ky sanksion nuk pasqyrore plotësisht masën e përgjegjësisë së tij, atij i duhet dhënë mundësia që të shprehë një kritikë të sinqertë dhe qëndrim të sinqertë kritik dhe vetë-kritik. Raporti konkludonte se pozita e tij e ardhshme në LKJ varej nga një qëndrim i tillë.

Komente 11. Ky raport është padyshim një dokument me rëndësi të madhe, i cili jo vetëm që demonstroi mjaft qartë influencën e madhe personale që Bakalli ka ushtruar në jetën politike të Kosovës dhe pasojat e shpërfilljes së tij neglizhente (ose të qëllimshme) mbi mënyrën sesi po rriteshin ndjenjat nacionaliste në Krahinë. Ky raport gjithashtu i jep të drejtë shtypit, veçanërisht ‘shtypit të Beogradit’, në vendimin e tij nëse situata e vërtetë ekspozohej me vonesë dhe ofron një rast që në praktikë është tejet pa përgjigje për autoritetet serbe që të ripohojnë e më pas të ushtrtojnë kontroll të rreptë mbi Kosovën. Për më tepër, në prag të publikimit të këtij raporti, mund të pritët që t’i kushtohet më shumë vëmendje incidenteve nacionaliste të të gjitha llojeve në të gjithë Jugosllavinë.

12. Pyetja që deri më sot ka mbetur pa përgjigje, është: Pse raporti është bërë publik tani? Kemi dëgjuar zëra të pakonfirmuara se mund të vijojë përjashtimi i Bakallit nga LKJ dhe procedurat penale. Siç po raportoj më vete, ka pasur kritika mbi ashpërsinë e disa dënimeve të caktuara për të rinjtë në Kosovë gjatë verës. Siç tregojnë të dhënat, Bakalli ka luajtur rol kryesor duke lejuar një shumicë ndjenjash nacionaliste që të përparonin shumë larg në Kosovë; Situata anormale e dhjetëra studentëve që vuajnë dënime të rënda ndërkohë që Bakalli është i lirë mund të mos jetë e

pranueshme për shumë kohë. I Juaji Charles Crawford Oficer Informacioni Për dijeni: P Rennie Esq Departamenti i Kërkimit, FCO

-100-

Për përdorim të kufizuar

RefNr: 15/2
Ambasada britanike
Beograd
29 shtator 1981
J C R Gray Esq
EESD, FCO
Inderuar Charles,

Kosova: më shumë ndryshime në udhëheqje

Përmbledhje

1. Siç pritej, Dushan Ristiq dha dorëheqjen si Kryetar i Kuvendit të Kosovës më 25 shtator, por jo pa dhënë një fjalim të hidhur për dorëheqjen e tij. Kreu i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës u zëvendësua. Gjithashtu u bënë disa ndryshime në udhëheqjen e Lidhjes Socialiste të Kosovës dhe RTV e Prishtinës.

Detaje

Kuvendi i Kosovës

2. Siç e parashikoi Terence Clark (në letërën e tij drejtuar Alan Montgomery më 10 gusht, paragrafi i fundit), procesi i diferencimit në Kosovë nuk ka përfunduar ende. Në një mbledhje të përbashkët të tre Dhomave të Kuvendit të Kosovës më 25 Shtator, Ilija Vakiq u zgjodh si Kryetari i ri i Kuvendit i cili zëvendësoi Dushan Ristiçin dhe Riza Sapunxhiu zëvendësoi Bahri Oruçin si Kryetar i Këshillit Ekzekutiv. (Vakiq (vl. 1930) ka ecur përpara përmes niveleve politike në Kosovë dhe është anëtar i Komitetit Krahinor të LKK; Sapunxhiu (vl.1925) ishte nën/kryetar i Këshillit Ekzekutiv, por ka një eksperiencë të gjatë në çështje biznesi dhe bankare të Kosovës).

3. Dorëheqja e pashmangshme e Ristiçit është diskutuar në letërën e përmendur të Terence Clark, por ai nuk kërkoi asnjë falje në fjalimin e tij të dorëheqjes. Ai pranoi një masë përgjegjësie të përgjithshme, por për përhapjen e aktivitetit armiqësor në Kosovë, ia vuri fajin “organizatës së papërgjegjshme dhe udhëheqjes së LKK”. Ai argumentoi se përgjegjësia e tij si Kryetari i Kuvendit de fakto ndryshonte shumë nga përgjegjësia e atyre personave, puna dhe rëndësia e të cilëve nënkuptonte se ata kishin qenë plotësisht të informuar. Ai mbështeti vlerësimet zyrtare të LKJ mbi shkaqet e trazirave në Kosovë dhe masat e marra për trajtimin e tyre. Për pasojë, sulmet e bëra ndaj qëndrimit të tij ishin të barazvlefshme me sulmet e bëra ndaj politikës së LKJ. Ky fjalim i hidhur u pranua pa komente.

4. Pas dorëheqjes së Uruçit (ai tashmë e kishte humbur punën e tij në Komitetin Krahinor të LKK - shih letërën e Terence Clark në bazë të Referencës) vijoi një kritikë e ashpër mbi performancën e kohëve të fundit të Kuvendit dhe Këshillit Ekzekutiv të Kosovës nga Muhamer Imeri, Kryetar i Komisionit të ngritur për të

shqyrtuar punën e Kuvendit dhe Këshillit. Ai tha se Kuvendi nuk kishte arritur të ushtronte kontroll të mjaftueshëm mbi Këshillin dhe në të ardhmen do të kishte bashkëpunim më të ngushtë midis Kuvendit të Kosovës dhe atij të Serbisë për të shmangur vonesat në miratimin e legjislacionit të ri. Kuvendi, kishte qenë veçanërisht i dobët në ushtrimin e përgjegjësisë të tij kushtetuese në fushën e bashkëpunimit me Shqipërinë. Edhe shërbimi i sigurisë në Kosovë kishte qenë i pakualifikuar dhe i çorganizuar. Në të ardhmen, vëmendje e veçantë do t’i kushtohej forcimit të lidhjeve me bazën e deleguar dhe sigurimit se kjo bazë do të kuptonte atë që diskutohej. Kuvendi e pranoi këtë vlerësim.

Lidhja Socialiste e Kosovës

5. Në letërën time dërguar për ju më 3 qershor, kam përmendur diskutimet mjaft të padobishme të Lidhjes Socialiste të Kosovës. Në një mbledhje të Komitetit Krahinor (KK) të Aleancës Socialiste të Popullit Punëtor të Kosovës (ASPPK), përsëri më 25 shtator, u paraqit një raport ku thuhej se KK mbante përgjegjësi të veçantë për paefektshmërinë e gjatë të ASPPK. Kryetari i KK, Mihailo Zvicer u zgjodh për përmendje të veçantë në këtë drejtim. Mustafa Rushiti (i cili, siç do ta kujtoni, filloi polemikën në shtyp në muajin shkurt duke sulmuar ‘shtypin e Beogradit’ – përmendur në letërën time dërguar për ju më 5 gusht) tha më pas se ai nuk do të fliste për përgjegjësinë e Zvicerit, meqenëse Zvicer ishte i sëmurë, por theksoi se ASPPK nuk e kishte pasur në agjendë çështjen e marrëdhënieve ndër-komunitare për 7 vjet. Josuf Kelmendi tha se ASPPK kishte qenë “pa mend” gjatë periudhës së kundërrevolucionit në Kosovë.

6. Më pas u pranuan kërkesat e Dr. Gazmend Zajmit dhe Muharrem Kryeziut që të liroheshin nga detyrat e tyre në KK, ndërsa Brigadier Gjeneral Fadil Çuranolli, Asllan Fazlia, Dr. Minir Dushi, Ismail Mikulovci, Desimir Jovanović, Nevzad Hudaverdi dhe Musa Beka u zgjodhën në KK, gjë që dukej si një përpjekje për të forcuar vendimet dhe efikasitetin e këtij Komiteti.

Ndryshime të tjera

7. Letra ime dërguar për ju me datë 15 korrik përmend (në paragrafin 4) se do të merreshin masa kundër Shaban Hysenit, Drejtor i Radio Prishtinës. Ai është pushuar në gusht dhe më 25 shtator është zëvendësuar nga Dragan Marković, ish drejtues i LKK lokale në Prizren. Fahredin Gunga, Drejtor i TV Prishtinës është zëvendësuar nga Agim Zatriqi (anëtar i Komitetit Krahinor të LKK). Petrit Dushi dhe Gojko Radovanović u pushuan nga postet e tyre si redaktorë kryesorë në RTV-në e Prishtinës. Në fund, u pushua gjithashtu edhe Emin Berisha, drejtor i Institutit të Statistikave Krahinore.

I Juaji

Charles Crawford
Oficer Informacioni

Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

-101-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
EESD
Beograd
FCO 30 shtator 1981
Inderuar Charles,

Kosova: analizë politike

1. Që prej raporteve tona të fundit për Kosovën, kanë dalë disa çështje që vlen të përmenden:

Siguria

2. Më 22 shtator Franjo Herleviq, Sekretari Federativ i Punëve të Brendshme, bëri një përmbledhje të situatës aktuale të sigurisë në Kosovë në këtë mënyrë: “numri i incidenteve ka rënë dhe jeta publike i është kthyer normalitetit, por situata e sigurisë ka mbetur e ndërlikuar. Aktiviteti armiqësor manifestohet përmes shkrimit të parullave, shpërndarjes së fletushkave; gjithashtu vazhdojnë të jenë të pranishme deklaratat verbale dhe veprimet e paligjshme. Ka pasur raste sabotimesh dhe dëmsh të qëllimshme”. Ky vlerësim i përgjithshëm është pasqyruar në raportet e shtypit në gusht dhe shtator.

Gjyqet

3. Në kritikën e parë të hapur dhe në nivel të lartë kemi parë disa nga dënimet e rënda që janë dhënë në serinë e gjyqeve të nacionalistëve gjatë verës. Mitija Ribçiq, Kryetar i Aleancës Socialiste të Popullit Punëtor të Slovenisë (ASPPS), tha në një intervistë në “Vjesnik” më 19 shtator, se Kosova ishte një “problem ekonomik, politik dhe vetë-menaxhues, jo çështje e gjykatave dhe prokurorëve ... një tetëmbëdhjetë vjeçar që nuk di asgjë dhe që mendon se parulla “duam Republikë” është diçka e re, nuk duhet të dënohet me dymbëdhjetë vjet burg. Do të ishte më mirë që t’i shpjegonim disa gjëra dhe të ndikonim tek ai në mënyrë të ndryshme, veçanërisht përmes arsimimit”. Ai tha se njerëzit që dënohen me periudha të gjata burgimi në këtë moshë do ta shihnin veten në mënyrë të shmangshme si heronj.

4. Herleviq dha përgjigjen e tij ndaj kësaj kritike në fjalimin e përmendur më lart. Duke iu referuar profilit të moshës së personave të dënuar në Kosovë, ai tha hapur se 90% e tyre ishin të rritur; për të miturit gjykata kishte dhënë masa rehabilituese-arsimore. Megjithatë, një grua përfaqësuese ngriti zërin kundër shkallës së rëndë të dënimeve në Mbledhjen e Përbashkët të Kuvendit të Kosovës më 25 shtator, duke pohuar se shumë njerëz në demonstrata kishin marrë pjesë nën presion. Disa përfaqësues e mohuan këtë pikëpamje. Njëri tha se, nëse ndokush ka qenë subjekt presioni, këta ishin pikërisht serbët dhe malazetët; nuk mund të kishte falje për ata që ishin dënuar, pasi po sulmohej sistemi kushtetues i Jugosllavisë. Me një shikim të papëlqyeshëm ndaj arritjeve të demokracisë jugosllave, Kuvendi u distancua nga pikëpamjet e saj dhe i kërkoi ‘bazës përfaqësuese’ të saj që të merrte masa të përgjegjshme ndaj saj.

5. Rastësisht, gazeta e sotme “Politika” raportoi se Kryesia e

Kosovës kishte deklaruar dje se ishte e kënaqur me veprimin e gjykatave deri tani në trajtimin e nacionalistëve dhe sjelljes së tyre kundërrevolucionare; Kryesia shtoi se “gjykatat duhet të shqyrtojnë të gjitha rethanat e afërta në vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë penale”, ndoshta një aluzion i vogël ky për gjykatat që të gjejnë disa faktorë lehtësues për të pandehurit e rinj.

Presioni ndaj serbëve dhe malazetëve për t’u larguar nga Kosova

6. Letrat e mia për ju të datave 17 qershor dhe 28 korrik bënin fjalë për “emigracionin” e serbëve dhe malazetëve nga Kosova. Hetimet në këtë drejtim kanë filluar të japin frytë, së paku në masën që është pranuar zyrtarisht në Kosovë se ka pasur raste të shumta kur njerëzit janë larguar pas “presionit” të ushtruar. Siç e tha gazeta NIN më 27 shtator, nëse kjo lëvizje do të vazhdojë, do të përhapet pikëpamja e përgjithshme se duhen fajësuar të gjithë shqiptarët në Kosovë dhe kjo situatë në mënyrë të pavetëdijshme do të sjellë më afër mundësinë për një “Kosovë etnikisht të pastër”. Serbëve dhe malazetëve u është bërë thirrje që të qëndrojnë. Por, siç sugjeroi një raport, nëse situata e përgjithshme politike është në vetvete një arsye e mirë që ata të largohen, atëherë progresi në këtë front të rëndësishëm do të jetë i vështirë. Më shumë fakte dhe shifra do ju dërgoj kur të përfundojnë hetimet zyrtare.

Diferencimi

7. Gazeta “Komunist” më 25 shtator raportoi se rreth 600 anëtarë të LKK ishin përjashtuar, shumica për “pasivitet”. Spastrimi ka qenë veçanërisht i theksuar në Universitetin e Prishtinës ku rreth 365 studentë janë përjashtuar për “pasivitet”; 19(!) studentë janë përjashtuar për pjesëmarrje në demonstrata ose për mbështetjen e tyre. Artikulli vazhdonte se “diferencimi” nuk ishte thjesht çështje dënimesh dhe përjashtimesh (në Ferizaj ishte kufizuar rreptësisht me zbulimin e pjesëmarrësve në demonstrata). Diferencimi duhej të ishte “një betejë për besim në LKJ, për zgjerimin e ndikimit të saj dhe për realizimin e rolit pararojë të saj”.

(Koment: cilido qoftë përkufizimi i diferencimit, nuk mendoj se kemi parë ende fundin e serisë së sanksioneve dhe përjashtimeve nga Partia në Kosovë).

I Juaji

Charles Crawford

PS Gjyqet (Rishqyrtuar)

Gjyqet e nacionalistëve në Kosovë duket se kanë përfunduar. Rreth 220 veta janë dënuar, pjesa më e madhe e të cilëve kanë marrë dënime të konsiderueshme me burgim. Megjithëse zyrtarisht është pretenduar se janë ndjekur të gjitha procedurat e rregullta ligjore, Terence Clark ka dëgjuar nga një mik avokat se, për ta thënë hapur, në shumë raste i është rënë shkurt. Do të përipiqemi të zbulojmë më shumë informacion në këtë drejtim; ndoshta Jugosllavia do të vihet në kohën e duhur nën sulmin e grupeve të tilla si ‘Amnistia’. Për dijeni: P Rennie Esq Departamenti i Kërkimit FCO

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Stadiumi Olimpik 'Adem Jashari' po rinovohet

PRISHTINË, 12 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se stadiumi Olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë

është duke u rinovuar dhe se pas përfundimit të këtij procesi ai do t'i takojë kategorisë 4 të UEFA-s. "Ky

stadium do të jetë i kategorisë së katërt të UEFA-s. Punët në këtë stadium janë duke u zhvilluar me

intensitet të lartë. Investitore e punëve në këtë stadium është MKRS-ja", thuhet në njoftimin e FFK-së.



Ballkani dhe Drita presin fitoret e radhës, Llapi kërkon këndelljen

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 PRILL - Tri klubet kryesuese, Ballkani, Llapi dhe Drita, do ta vazhdojnë garën për titull edhe në javët në vazhdim. Kampionët në fuqi u rikthyen në krye të renditjes tabelore pas fitores ndaj Lirisë, tri pikë presin edhe ndaj Feronikeli 74' në Drenas për ta ruajtur pozitën e parë dhe për të ecur sigurt drejt titullit. Në anën tjetër, vendasit që luftojnë për t'i ikur zonës së barazhit do të mundohen të nxjerrin një rezultat pozitiv, prandaj kjo ndeshje do të jetë interesante.

Drita, që është rikthyer fuqishëm në garë për titull, kërkon tri pikë të reja edhe në përballjen jo aq të vështirë ndaj Lirisë, e cila tashme është pajtuar se sezonin tjetër do të bëjë gara në Ligën e Parë. Trajneri Zekrija Ramadani ka thënë se skuadra e tij nuk do t'i përsërisë gabimet e së kaluarës ndaj Lirisë, por do ta regjistrojë

fitoren e radhës. "Ndeshjen e radhës e kemi kundër Lirisë. Skuadër që i ka krijuar vështirësi Dritës, por jam i bindur se ekipi ka marrë mësim nga e kaluara. E kam parë gjatë kësaj jave një seriozitet të madh në ekip, duke e pritur ndeshjen ndaj Lirisë si një finale. Na kanë ngelur edhe tetë ndeshje dhe secila e ka rëndësinë e vet. Edhe ndeshja

SUPERLIGA / Javë e 29-të

Të shtunën takohen:
Drita - Liria
Prishtina - Gjilani
Feronikeli 74' - Ballkani

Të dielën takohen:
Dukagjini - Llapi
Fushë Kosova - Malisheva

Tabela

		Pikë
1. Ballkani	28	56
2. Llapi	28	54
3. Drita	28	54
4. Malisheva	28	49
5. Prishtina	28	40
6. Dukagjini	28	36
7. Gjilani	28	30
8. Feronikeli 74	28	30
9. Fushë Kosova	28	20
10. Liria	28	10



me Lirinë vlen tri pikë. Me seriozitet besoj se do ta arrijmë objektivin në këtë ndeshje. Kemi disa shqetësime në ekip që nuk do t'i përmendi tash dhe ndaj Lirisë na intereson vetëm fitorja dhe besoj se do ta gjemë formacionin e duhur për të arritur tri pikët", ka thënë Ramadani. Të shtunën do të zhvillohet edhe

ndeshja në mes të Prishtinës dhe Gjilanit. Kryeqytetasit janë në vendin e pesë me 40 pikë, kurse gjilanasit kanë dhjetë pikë më pak dhe renditen në pozitën e shtatë. Të dielën Llapi që humbi pozitën e liderit në javën e kaluar, përballet me Dukagjinin në Klinë. Kjo ndeshje nuk do të jetë aspak e lehtë për djelmoshat e Tahir

Batatinës, pasi Dukagjini është një skuadër e papërshtatshme kur luan si vendas. Llapi është në pozitën e dytë me 54 pikë, derisa Dukagjini është në vendin e gjashtë me 36 pikë. Ndeshja e fundit është ajo mes Fushë-Kosovës dhe Malishevës. Të gjitha ndeshjet do të zhvillohen nga ora 15:00.

Vëmendja në Mitrovicë, të shtunën Trepça - Besa Famgas



MITROVICË, 12 PRILL - Trepça e Besa Famgas përballen në ndeshjen më interesante të xhiros së 26 të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Dy skuadrat që fituan trofetë e edicionit të kaluar, takohen në palestrën "Minatori" në Mitrovicë të shtunën nga ora 19:00. Kampionia aktuale, Besa Famgas, është e frymëzuar nga fitorja ndaj Rahovecit javën e kaluar. Pejanët synojnë të vazhdojnë me fitore në prag të

fazës finale të garave. Ndërkohë Trepça angazhoi tre lojtarë të huaj së fundi dhe synon ta rivalizojë Besën deri në fund, me shpresë për dy pikë të mëdha. Besa Famgas është e dyta me 42 pikë. Prej pozitës së dytë do të startojë në plejof. Trepça është e katërta me 30 pikë. Të shtunën janë edhe dy ndeshjet e tjera të xhiros së 26. Nga ora 12:30 takohen Prishtina e Vëllaznimi. Prishtina është e pesta me 21 pikë, ndërsa Vëllaznimi i shtati me tetë pikë.

Nga ora 20:00, Rahoveci e pret Vushtrrinë. Rahoveci synon të kthehet te fitorja pas disfatës në Pejë nga Besa. Rahoveci është lider me 48 pikë. Ishte në seri prej 24 fitoreve deri të shtunën e kaluar. Vushtrria është e gjashta me 11 pikë. Në Ligën e Parë të hendbollistëve zhvillohet xhiroja e 15-të. Të shtunën janë takimet: Prizreni - Vjosa (19:00), Istogu - Lepenci (15:30), Ulpiana - Drita (18:00), Drenica - Llapi (19:00). Samadrexha - Dukagjini luhet të hënën nga ora 20:00.

Khaka: E dimë se mund ta shkruajmë historinë

LEVERKUSEN, 12 PRILL - Bayer Leverkuseni e zhvillon të dielën ndeshjen ndaj Werder Bremenit dhe, në rast fitoreje, do të shpallet matematikisht kampion i ri i Bundesligës. Përveç kësaj,

Leverkuseni i udhëhequr nga Xabi Alonso është në finale të Kupës së Gjermanisë dhe në çerekfinale të Ligës së Evropës. E Granit Khaka u shpreh se do të shkruajnë historinë. "Ne e dimë se

mund ta shkruajmë historinë. Për klubin, për tifozët, për veten tonë. Ne do të bëjmë gjithçka që mundemi për ta përfunduar punën. Edhe një herë lojtarët vijnë nga banka

rezervë dhe vendosin lojën. Ne kemi një skuadër ku të gjithë bëjnë pjesë në njëmbëdhjetëshin fillestar. Ju fitoni ndeshje me pak lojtarë, por si ekip fitoni tituj", ka thënë Khaka.



Khaka dhe Gjimshiti në formacionin e javës në Ligën e Evropës

LEVERKUSEN, 12 PRILL - Dy yjet shqiptarë, Granit Xhaka dhe Berat Gjimshtiti, kanë fituar vend në formacionin më të mirë të javës në ndeshjet e para çerekfinale të Ligës së Evropës. Roma mposhti 0-1

Milanin, Bayer Leverkuseni fitoi 2-0 ndaj West Hamit, Benfica fitoi ndaj Marseille 2-1 dhe Liverpooli u turpërua 0-3 nga Atalanta. Pas ndeshjes, faqja e specializuar e statistikave

“SofaScore” ka publikuar formacionin më të mirë të ndeshjeve të para. Leverkuseni dominoi formacionin me gjashtë lojtarë, e ndjekur nga Atalanta me dy lojtarë,

ndërsa Roma, West Hami dhe Liverpooli patën nga një. Formacioni: Fabianski, Gjimshiti, Tah, Mancini, Xhaka, Hofmann, Wirtz, Palacios, Aldi, Scamacca, Gakpo.



Alarmohet Gjermania, ISIS kërcënon ‘Euro 2024’ me disa foto rrëqethëse

BERLIN, 12 PRILL - Shërbimet e sigurisë gjermane janë alarmuar për sulme të mundshme terroriste nga ISIS gjatë Kampionatit Evropian të Futbollit, të cilin shteti perëndimor do ta presë këtë verë. Masat e sigurisë janë shtuar në Paris, Madrid dhe në stadiumin e Arsenalit pas kërcënimeve nga ISIS disa ditë më parë për t'i sulmuar stadiumet ku do të zhvillohen ndeshjet çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Për fat të mirë, ndeshjet u zhvilluan pa u konkretizuar kërcënimet e xhihadistëve, por autoritetet franceze madje mobilizuan njësinë elitare kundër terrorizmit BRI, pas një postimi në median “Al Azaim”, e cila riprodhon mesazhe nga ISIS-K, një krah i Shtetit Islamik. Sipas “Bild”, shkrimi i fundit i “Zërit të Khorasanit”, mediumi propagandistik i ISIS-K, përmban edhe një thirrje për sulme terroriste, e cila, sipas zyrtarëve gjermanë të sigurimit, e vendos “Euro 2024” në pikëpyetje. Shkrimi përfshin gjithashtu një seri fotografish, duke përfshirë një që tregon një terrorist të armatosur në një tren hekurudhor gjerman, me mbishkrimin “Thirra e fundit para daljes”. Në ulësen pranë saj është një kuti me



dinamit nën një tabelë që thotë “Mirë se erdhe në Evropë”. Një tjetër foto tregon një dron që fluturon mbi stadiumin “Santiago Bernabeu” të Real Madridit me mbishkrimin “Nëse po ju kufizojnë dhe ju shtypin në tokë, goditini nga qielli. Nëse armiqtë e fesë së Allahut bllokuan rrugën e Hegirës, ata nuk mund ta bllokojnë rrugën e luftës”. Teksti i ISIS vazhdon kërcënimet: “Shtypini të pafetë me makinat tuaja, goditini me thika, helmoni ushqimin e tyre, fryni trurin me plumba dhe vini zjarrin shtëpive të

tyre”. Zyrtarët gjermanë të sigurisë besojnë se krahu i ISIS-K ka një rrjet të organizuar prej më shumë se 100 xhihadistësh në Evropën Perëndimore, gjysma e të cilëve janë në Gjermani. “Ky artikull propagandues tregon se ISIS-K dëshiron të kryejë sulme spektakolare me çdo kusht, pavarësisht se si dhe nga kush. Kjo është arsyeja pse të gjithë autorët e mundshëm, duke përfshirë individët e radikalizuar dhe të ashtuquajturit ujçer të vetmuar, tani po thirren për të nisur sulmet”, ka thënë një zyrtar për “Bild”.

Bostoni mendon për ‘play-off’-in, Golden State dhe Chicago fitore për renditje

BOSTON, 12 PRILL - Golden State arriti një fitore të rëndësishme ndaj Portlandit jashtë fushës me shifrat 100-92, duke parakaluar lakersat në renditje. Curry me 22 pikë ishte shënuesi më i mirë për Warriorsin. Humbja e dytë radhazi për Bostonin, që u mund me rezultat 118-109 në shtëpi nga New Yorku. Një humbje pa pasoja për Celticsin, që mbetet ekipi më i mirë në NBA këtë sezon, i vetmi që ka kaluar kuotën e 60 fitoreve. Skuadra e Chicagos mundi me rezultat 127-



105 Detroitin, ndeshje ku për Bulls-in u dallua DeRozani, autor i 39 pikëve. Fitoi edhe Utah Jazzi me rezultat

124-121 ndaj Houstonit, sfidë ku protagonist ishte VanVleet me 42 pikë, por që s'mjaftuan për miqtë.

REZULTATET

Detroit - Chicago	105-127
Boston - New York	109-118
Utah Jazz - Houston	124-121
Portland - Golden State	92-100
Sacramento - New Orleans	123-135

SHKURT

Klopp: Atalanta e meritoi të fitonte

Liverpooli pësoi humbje të rëndë ndaj Atalantës në Ligën e Evropës me rezultat 0-3. Trajneri Jurgen Klopp e ka pranuar se skuadra italiane e ka merituar fitoren në këtë ndeshje. Ai ka thënë se nuk ka energji për të menduar për ndeshjen e kthimit dhe përmbysjen e rezultatit. “Atalanta e meritoi të fitonte, luftoi për çdo top, ishte kompakte në mbrojtje, doli mirë. Rezultatit tani të gjithë e njohim. A besoj te përmbysja? Nuk kam energji për të menduar për ndeshjen e kthimit. Është e qartë se do të shkojmë për të fituar. Ata mbrohen mirë, luajnë në shtëpinë e tyre dhe do të jetë shumë e vështirë”, ka shtuar Klopp.

Gasperini: Është një rezultat i jashtëzakonshëm

Trajneri i Atalantës, Gian Piero Gasperini, nuk e ka fshehur gëzimin për fitoren e madhe në “Anfield” me rezultat 0-3. Ai ka thënë se ky është një rezultat që do të mbesë përgjithmonë në kujtesën e tifozëve. “Është një rezultat i jashtëzakonshëm, i shkëlqyer për historinë e Atalantas, për shoqërinë, për tifozët. Ky është një nga ato rezultate që mbesin në kujtesë përgjithmonë. Një fitore e madhe. Luajtëm në një stadium historik, i famshëm në të gjithë Evropën. Dy vjet më parë kur fituam këtu nuk kishte tifozë, por këtë herë kishte një shije tjetër. Sot jam shumë i lumtur. Kemi hedhur një hap të rëndësishëm, por Liverpool është një ekip i shkëlqyer që mund të shënojë gola në pak minuta. Është një skuadër që ka treguar se di të përmbysje ndeshje. Mjafton ta kujtojmë finalen e Ligës së Kampionëve me Milanin”, ka thënë Gasperini.

Alonso rinovon kontratën me Aston Martinin

Fernando Alonso do të vazhdojë të garojë në Formula 1 me Aston Martin sezonin e ardhshëm, pasi ekipi njoftoi se dy herë kampioni i botës ka nënshkruar një marrëveshje të re deri në vitin 2026. Alonso bëri lëvizjen tek Aston Martin nga Alpine në vitin 2023 dhe të dyja palët shijuan një fillim të fortë të partneritetit të tyre duke arritur gjashtë pozicione në podium në tetë garat e para të fushatës së vitit të kaluar. Pas njoftimit të kalimit të Lewis Hamiltonit te Ferrari për vitin 2025, pati gjithashtu shumë spekulime mbi të ardhmen e Alonsos, fillimisht në lidhje me atë nëse ai do të angazhohej apo jo në një tjetër sezon në F1 dhe, nëse po, nëse do të ishte me Aston Martin. Por të dyja këto pyetje tani kanë marrë përgjigje, me lajmet që u publikuan të enjten pasdite se Alonso do ta zgjasë qëndrimin. Aston Martin është i pesti në renditjen e konstruktorëve pas katër raundeve hapëse të vitit 2024, pas Mercedesit, McLarenit, Ferrarit dhe liderit Red Bullit.

De Rossi: Treguam guxim ndaj Milanit

Daniele de Rossi është shprehur i kënaqur me fitoren e Romës ndaj Milanit (0-1) në çerekfinale të Ligës së Evropës. Strategu italian ka deklaruar se në këtë ndeshje i ka pëlqyer gjithçka nga pak tek Roma, derisa ka lavdëruar edhe Lukakun. “Nga kjo ndeshje më pëlqeu pak nga të gjitha, më pëlqeu guximi për ta mbajtur topin, forca për t'u mbrojtur. Në këtë sfidë pashë edhe Lukakun në ditën e tij më të mirë që kur unë kam ardhur këtu. Bëri spondën, na lejoi të dilnim përpara, bëri pikërisht atë që pres prej tij. Ndeshja e kthimit? Milani sigurisht mendonte të fitonte në shtëpi për të administruar më pas ndeshjen e kthimit. Sjellja e tyre pritet të jetë e njëjtë, por nëse në luajmë në stadiumin tonë si 10 minutat e fundit në ‘San Siro’ do të na shpartallojnë”, u shpreh De Rossi.

Pioli: Goli i Romës ishte i parregullt, neve na u mohua një penallti

Trajneri i AC Milanit, Stefano Pioli, pas humbjes nga Roma në ndeshjen e parë çerekfinale të Ligës së Evropës, ka thënë se goli i fitores për skuadrën kundërshtarë erdhi nga një

pozicion jashtë loje. “Kemi pasur disa vështirësi në pjesën e parë. Na u desh të bënim zgjedhje më të qarta dhe më të guximshme pa top. Ata krijuan disa situata, por më pas pësuan

gola nga një kënd, ku ata u treguan më të zgjuar se ne. Në pjesën e dytë më pëlqeu skuadra dhe ne e luajtëm ndeshjen, ndoshta jo me qartësinë dhe cilësinë e

zakonshme. Tani ka mbetur edhe një ndeshje dhe skuadra mund të bëjë shumë më mirë. Këndi nga i cili shënoi Mancini ndoshta erdhi nga një pozicion jashtë loje i Lukakut dhe pranë

fundit Abraham kapi topin me dorë brenda zonës dhe jo me kokë. Fatkeqësisht nuk ishim shumë me fat me këtë gjyqtar. Përmbysja e rezultatit nuk do të jetë e lehtë”, ka thënë Pioli.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Paper Communications” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810795809 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Paper Communications” D.O.O. od Prishtine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810795809 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Paper Communications” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810795809 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Paper Media” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810831356 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Paper Media” D.O.O. od Prishtine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810831356 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Paper Media” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810831356 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M. "Uniteti" SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendrike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Dy (2) Vozitës të kat.”C” - KRM “Uniteti” Sh.A Mitrovicë - i Konkursit të shpallur me datë 22.03.2024

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej datës **13.04.2024**. deri me datë **19.04.2024** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M”Uniteti”Sh.A.-Mitrovicë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Agon Reznici nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e lëshuar nga Q.A.O. në Gjakovë Instalues i Elektrikes.

- Naser Bordoniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Faton Babuni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. “N. Nixha” Aotomekanik Gjakovë.

- Driton Bajram Halabaku shpall të pavlefshme Diplomën e Masterit, drejtimi Juridik-Civil me nr. 895 të Universitetit “Hasan Prishtina” Prishtinë,

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma

të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

